

NË GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT

Lënda numër P. 233/2013

30 tetor 2013

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT, në Trupin Gjykses të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons, si kryetar i trupit gjykses, dhe gjyqtari Zejnullah Gashi dhe gjyqtari i EULEX-it Manuel Soares, si anëtarë të trupit gjykses, dhe Valentina Gashi, si proces-mbajtëse, në lëndën penale kundër:

A.B., i njohur gjithashtu si A.M., D.B., B.H dhe ‘T’; lindur B.H.^{1 2} më xxx, në xxx, Qarkut i Drenasit, Kosovë, mashkull, numri i letërnjoftimit xxx, emri i babait M.H, emri i nënës K.C., shqiptar i Kosovës, shtetas i Kosovës, me banim në xxx, Qarku i Drenasit, i martuar, ka xxx fëmijë, gjendja ekonomike mesatare, në paraburgim që më 17 prill 2012;

I AKUZUAR me Aktakuzën e Prokurorit Special të EULEX-it, PPS nr. 50/2011, datë 15 prill 2013, dhe e paraqitur më 16 prill 2013, e ndryshuar më 30 tetor 2013, me Akuzat e mëposhtme:

AKUZA 1

KRIM I ORGANIZUAR, në shkelje të nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3, të Kodit Penal të Kosovës, vepër e dënueshme me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet

¹ changed his name to A.B. at the Kosovo Civil Registration Agency on 3 July 2009, number 201-3874

² E ndryshoi emrin e tij në A.B. në Zyrën e Gjendjes Civile më 3 korrik 2009, numër 201-3874.

SEPSE midis 5 shkurtit 2012 dhe 17 prillit 2012, **A.B.** në territorin e Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë dhe Italisë, kreu veprën penale të Krimin të Organizuar nëpërmjet:

1. Organizimit, mbikëqyrjes, administrimit ose drejtimit të veprimtarive të një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga O.K., C.K., E.K., L.K., 'N.', A.B., A.C., N.N., M.B., A.M., I.H., M.H.("B"), T.H., Sh.B., N.P., Z.G., M.C., Z.M., G.N. dhe kryerës të tjerë të paidentifikuar;
2. Kryerjes së një krimi të rëndë, përkatësisht Kontrabandës së Migrantëve, në kuadrin e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga O.K., C.K., E.K., L.K., 'N.', A.B., A.C., N.N., M.B., A.M., I.H., M.H.("B"), T.H., Sh.B., N.P., Z.G., M.C., Z.M., G.N. dhe kryerës të tjerë të panjohur, dhe/ose
3. Pjesëmarrjes aktive në veprimtari kriminale ose të tjera të grupit të organizuar kriminal të cekur, me dijeninë se kjo pjesëmarrje do të kontribuonte në kryerjen nga grupi të krimeve të rënda të cekura, me qëllimin për të siguruar, direkt ose indirekt, përfitim financiar ose përfitim tjetër material.

AKUZA 2

KONTRABANDIM I MIGRANTËVE, në shkelje të nenit 138 (1) të Kodit Penal të Kosovës, në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPK-së,

SEPSE më 3 shkurt 2012 dhe 17 prill 2012, **A.B.**, në territorin e Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë dhe Italisë, kreu veprën penale të kontrabandimit të migrantëve, duke u përfshirë në kontrabandimin e personave të cilët nuk janë shtetas ose banorë të përhershëm të shtetit, për të kaluar kufirin pa vepruar në përputhje me rregullat për hyrje të ligjshme, për migrantët e mëposhtëm:

- (1) Midis 5 shkurtit 2012 dhe 25 shkurt 2012, duke kontrabanduar Z.G., shtetase turke, A.G, shtetas turk, M.G, shtetas turk, R.G, shtetas turk, B.G, shtetas turk, dhe G.K, shtetas turk, nga Kroacia përmes Sllovenisë për në Itali.
- (2) Midis 26 shkurtit 2012 dhe 10 marsit 2012, duke kontrabanduar H.K, shtetas turk, dhe G.K, shtetas i Kosovës, nga Kroacia përmes Sllovenisë për në Itali.
- (3) Midis 24 shkurtit 2012 dhe 16 marsit 2012, duke kontrabanduar A.B.1,, shtetas i Kosovës, M.H.,, shtetas i Kosovës, R.J.,, shtetas i Kosovës dhe A.K.,, shtetas i Kosovës, nga Kosova, përmes Malit të Zi dhe Kroacisë, në Slloveni, me destinacion të synuar Italinë.
- (4) Midis 17 marsit 2012 dhe 28 marsit 2012, duke kontrabanduar Burimin (mbiemri i paditur) dhe dy migrantë të tjerë nga Kosova përmes Malit të Zi dhe Kroacisë, për në Slloveni, me destinacion të synuar Italinë.

PAS mbajtjes së seancave të hapura të shqyrtimit gjyqësor më 28 dhe 30 tetor 2013, në prani të të akuzuarit A.B., mbrojtësit të tij, H.K, dhe në prani prokurorit special të EULEX-it, Cumming Alister, të Prokurorisë Speciale të Kosovës, dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 30 tetor 2013,

NË BAZË TË nenit 359 të Kodit të Procedurës Penale³ (në tekstin e mëtejme “KPP”), sot më 30 tetor 2013, në seancë të hapur dhe në prani të të akuzuarit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit special të EULEX-it, Gjykata shqipton dhe shpall këtë:

³ Ligji Penal Nr. 04/L-123

AKTGJYKIM

A.B., me shënimet personale si më lart, në paraburgim që më 17 prill 2012, shpallet si më poshtë:

Në bazë të Nenit 363 paragrafi 1 (1.1) të KPP-së,

Akuza 1: **HIDHET POSHTË** sepse prokurori e tërhoqi akuzën gjatë shqyrtimit gjyqësor;

Më tej, në bazë të nenit 365 të KPP-së,

Akuza 2: **FAJTOR** për kontrabandim të migrantëve, në shkelje të nenit 138 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (këtej e tutje “KPK”), në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 23 të KPK-së.

SEPSE i akuzuari, A.B., u përfshi në kontrabandim të migrantëve, kryesisht me origjinë turke, nga Kosova për në Kroaci dhe Slloveni dhe më tutje drejt destinacionit përfundimtar të tyre në Itali dhe në vende të tjera të BE-së, përfshirë Hungarinë, Austrinë, Gjermaninë, dhe vende të tjera të Europës Perëndimore. Konkretisht:

1. Midis 5 shkurtit 2012 dhe 25 shkurtit 2012, A.B., kontrabandoi ilegalisht një grup prej gjashtë migrantësh turq nga Kroacia në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar. Këta migrantë u identifikuan si Z.G., e lindur më xxx, A.G., i lindur më xxx, M.G., i lindur më xxx, B.G., i lindur më xxx, dhe G.K, i lindur më xxx.

Planifikimi i veprës penale filloi më 5 shkurt 2012, kur A.B. hyri në një marrëveshje me ‘N.’, një rekrutues dhe organizatori kryesor në nivel ndërkombëtar, për të kontrabanduar

rregullisht migrantë përmes Malit të Zi dhe Kroacisë për në Slloveni dhe Itali. Pas kësaj marrëveshjeje, A.B. kontaktoi me anëtarë të tjerë të grupit kriminal nga 06 deri më 19 shkurt 2012, me qëllimin që t'i përgatisnin migrantët. Këta anëtarë përfshinin Z.G.1 në Kroaci, Sh.B. në Itali, A. (mbiemri i paditur) në Kosovë, dhe një anëtar të paidentifikuar të grupit në Mal të Zi. A. do të punonte me A.B. në Kosovë për të bashkërenduar shoferët, ndërsa Z.G.1 do të kujdesej për transportin e migrantëve në Kroaci drejt Sllovenisë, ndërsa Sh.B. do të mbikëqyrte kalimin e tyre më tutje në Itali dhe transportin më tutje.

Planifikimi i operacionit u konkretizua më tej më 21 shkurt 2012, kur A.B. hyri në marrëveshje të drejtpërdrejtë me L.K., një organizatore kryesore në një nivel më lart se 'N' në të njëjtin grup të organizuar kriminal, për të kontrabanduar një grup prej gjashtë personash në ditët e ardhshme. Këta gjashtë migrantë ishin shtetasit turq Z.G., A.G., M.G., B.G dhe G.K.. L.K. e informoi A.B. se migrantët përbëheshin nga një familje prej pesë të rriturish dhe një fëmijë shtatë vjeçar. Ai ra dakord për kontrabandimin e këtyre personave nga Zagrebi, Kroaci, për në Itali. Anëtarët e tjerë të grupit më të gjerë kriminal ndërkombëtar i kishin transportuar tashmë këta migrantë nga Turqia në Kroaci, ku atje do t'i merrte përsipër A.B.. Secilit migranti i ishte kërkuar të paguante 1400 euro vetëm për transportimin e tyre nga Kroacia përmes Sllovenisë për në Itali.

Ndërsa L.K. ishte pika e drejtpërdrejtë dhe kryesore e kontaktit për A.B., drejtimi i përgjithshëm i ishte dhënë asaj nga bashkëshorti i saj O.K., udhëheqësi i grupit kriminal. Kjo është demonstruar kur Luljeta i kërkoi leje O, ndërsa ishte duke folur në telefon me A.B. për operacionin e ardhshëm. Edhe A.B. mori udhëzime drejtpërdrejt nga O.K. në lidhje me kontrabandimin e këtij grupi të veçantë migrantësh. Në veçanti, O.K. pyeti në lidhje me shoferët, kohën dhe modalitetet e lëvizjes së migrantëve dhe hyrjen në vendin e destinacionit të planifikuar, dhe ku do të akomodohehin migrantët në Rjekë dhe paratë që do të merreshin prej tyre në Kroaci. C.K., vëllai i O., u përfshi gjithashtu në organizimin e kontrabandimit nga Turqia dhe komunikoi drejtpërdrejt me A.B..

Roli A.B. ishte të komunikonte me transportuesit nga Kroacia në Slloveni, për në Itali, fazat vendimtare të udhëtimit të migrantëve, duke pasur parasysh se këto ishin fazat kur krimi u konkretizua me kalimin e paligjshëm të kufijve për në shtetet e BE-së. Për këtë, A.B. foli me M.C.. M.C. i organizoi shoferët drejtpërdrejt, duke komunikuar përsëri me A.B., shpesh për të marrë udhëzime dhe për të rënë dakord lidhur me marrëveshjen për paratë. Për më tepër, A.B. organizoi akomodimin e migrantëve në Opatija, Kroaci, në “Hotel Opatija” të administruar nga G.N, një anëtare tjetër e grupit në Kroaci, e cila gjithashtu punon me M.C.

Përveç kësaj, A.B. u përfshi në aktivitetet në Slloveni, me bashkëpunëtorin e tij të njohur si R.L., i cili kontribuoi në kryerjen e veprës si shofer i grupit nga Sllovenia në Itali.

Në mbrëmjen e datës 23 shkurt 2012, migrantët u nisën nga Zagrebi, Kroaci, për në Rjekë, Kroaci, në dy grupe. Një pjesë e grupit shkoi me taksi për 350 euro nga Zagrebi në Rjekë, ndërsa pjesa tjetër shkoi me autobus, pasi A.B.i shprehu shqetësimin e tij L.K. se ata do të kapeshin në qoftë se do të udhëtonin të gjithë me taksi natën. Në Rjekë ata u takuan nga shoferët e organizuar nga M.C., i cili i dërgoi ata në “Hotel Opatija” të administruar nga G.N... Migrantëve iu kërkua të paguajnë 200 euro për të qëndruar një natë. Më 24 shkurt 2012, A.B. diskutoi për organizimet përfundimtare me M.C. për transportimin e migrantëve nga Rjeka, Kroaci, për në Slloveni dhe më pas në Itali. M.C. dhe një bashkëpunëtor tjetër udhëtuan për në Rjekë atë mbrëmje, me qëllim që të ishin gati për t’i transportuar migrantët të nesërmen në mëngjes.

Më 25 shkurt 2012, rreth orës 05:00, M.C. dhe një shofer tjetër i morën migrantët nga Hotel Opatija. Në këtë pikë, migrantëve iu kërkua t’u dorëzojnë edhe 1,200 euro të tjera shoferëve (500 euro njërit, 700 euro tjetrit). Tre migrantë udhëtuan në secilin prej të dy automjeteve në drejtim të kufirit kroat me Slloveninë. Në fakt kufiri u kalua në Starod, ku migrantët hynë në Slloveni ilegalisht dikur para orës 11:00.

Rreth orës 11:00 atë ditë, migrantët u takuan nga një shofer tjetër me një automjet Mercedes në Račice, rajoni Ilirska Bistrica, Slloveni, që ishte siguruar nga A.B. për t'i dërguar ata në Itali. Plani i mëparshëm kishte qenë t'i sillnin ata në Udine, Itali, por atë ditë shoferi i dërgoi ata drejt Triestes, Itali.

Migrantët Z.G., A.G., M.G., B.G. and G.K., u ndaluan të gjithë në një pikë kontrolli të policisë pasi kaluan ilegalisht në Itali midis orës 11:00 dhe orës 13:00, dhe i kthyen prapsh në Slloveni, ku u arrestuan nga Policia Sllovene në rajon Ilirska Bistrica.

Moshat dhe identitetet e migrantëve përputhen me rrethanat faktike të komunikuara në thirrjet e përgjuara të A.B., domethënë, se migrantët ishin një familje, përfshirë një fëmijë. Veçanërisht, fëmija më i vogël i grupit (B.G) ishte vetëm xxx vjeç në kohën e ngjarjeve, madje edhe më i vogël se mosha e treguar xxx vjeç. Përveç kësaj, u kontrabanduan edhe tre fëmijë të tjerë pasi në atë kohë R.G. ishte xxx vjeç, A.G xxx vjeç dhe M.G. xxx vjeç. Vetëm dy anëtarë të grupit ishin të rritur (Z.G., xxx, dhe G.K., xxx).

2. Midis 26 shkurtit 2012 dhe 10 marsit 2012, A.B. kontrabandoi ilegalisht dy migrantë nga Kroacia në Slloveni, me Italinë si destinacion i synuar. Këta migrantë u identifikuan si H.K, shtetas turk, i lindur më xxx (aso kohe xxx vjeç), dhe G.K., shtetas i Kosovës, i lindur më xxx (aso kohe xxx vjeç).

Planifikimi i veprës penale filloi më 26 shkurt 2012, kur A.B. pranoi të kontrabandonte G.K. nga Kosova për në Itali. Më tej, më 27 shkurt 2012, A.B. ra dakord me vëllezërit K. të transportonte dy migrantë turq nga Zagrebi, Kroaci, për në Itali. Migrantët ishin transportuar tashmë nga Turqia në Kroaci nga anëtarë të tjerë të grupit të organizuar kriminal ndërkombëtar. Më 6 mars 2012, O.K. thirri A.B. personalisht, në të cilën bisedë u sqarua se do të shkonte një migrant turk. Ky migrant që do të kontrabandohej ishte H.K.. Më vonë atë ditë, A.B. ra dakord me L.K. që H. të transportohej në të njëjtën kohë me migrantin nga Kosova.

Roli kryesor i A.B. ishte të komunikonte me transportuesit nga Kroacia për në Slloveni, për në Itali, fazat në të cilat krimi u konkretizua përsëri me kalimin e paligjshëm të kufijve për në shtetet e BE-së. Për këtë, A.B. diskutoi për aktivitetet në Kroaci me M.C., i cili organizoi shoferët. A.B. ngarkoi me detyrë edhe G.N., e cila ofroi strehim në “Hotel Opatija” pranë Rjekës, Kroaci. . M. dhe G. i raportuan edhe Z.M., menaxher i grupit kriminal në Kroaci.

Për më tepër, A.B. punoi me Sh.B., shtetas i Kosovës, T.H, shtetas i Kosovës, dhe H.B, shtetas serb që jetonte në Mal të Zi, të cilët shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues. Këta tre anëtarë të grupit i shoqëruan migrantët drejtpërdrejt përgjatë udhëtimit. Edhe ata vetë hynë ilegalisht në Slloveni.

Migrantët u nisën nga Rjeka, Kroaci, për në Slloveni më 8 mars 2012, kaluan kufirin në mënyrë të paligjshme në rajonin e Ilirska Bistricas, Slloveni, me varkë në afërsi të Koperit. Ata vazhduan udhëtimin e tyre drejt Italisë natën e 9 marsit 2012, në përpjekje për t’iu shmangur policisë kufitare.

A.B. komunikoi drejtpërdrejt me migrantët përgjatë rrugës, duke u treguar atyre në detaje të sakta ku të kalonin midis Sllovenisë dhe Italisë. Nga këto komunikime, natyra e paligjshme e hyrjes është jashtëzakonisht e qartë. Për shembull, ai i udhëzoi migrantët të mos kapërcenin gardhin, por të ecnin përreth tij, përmes shinave të trenit, sepse kishte qen roje. Më tej ai i drejtoi migrantët të ecnin nëpër pisha drejt Italisë, duke u treguar se ata po hynin në Itali nëpërmjet një pike të kalimit të paligjshëm nëpër pyll.

Migrantët H.K., dhe G.K, si dhe transportuesit Sh.B., H.B., T.H., u ndaluan të gjithë në një postbllok të policisë pasi kishin hyrë ilegalisht në Itali në orët e hershme të 10 marsit 2012. Ata i kthyen prash në Slloveni, ku u arrestuan nga policia sllovene në rajonin Ilirska Bistrica.

Nga komunikimet e përgjuara në kohën pas arrestimeve, u zbulua roli i Sh.B., H.B., T.H. si transportues të grupit kriminal. Ata i vendosën në një kamp për migrantët e paligjshëm në

Kroaci, bashkë me dy migrantët, pasi edhe hyrja e tyre ishte e paautorizuar. T.H. dhe G.K u liruan dhe i kthyen prapsh për në Kosovë më 15 mars 2012, ndërsa Sh.B. u lirua dhe e kthyen prapsh më 16 mars 2012. Në veçanti, natyra e paligjshme e aktiviteteve të tyre në Kroaci është demonstruar nga sugjerimi që A.B. i bëri Sh.B. që të dilte me një justifikim për praninë e tyre në Kroaci për Policinë Kufitare të Kosovës pas mbërritjes në aeroportin e Prishtinës, gjë që nuk ishte e vërtetë.

Mbikëqyrja fotografike e A.B. nga Policia e EULEX-it më 12 mars 2012 vërteton më tej provat e përfshirjes së tij në këtë operacion kontrabandimi, pasi ai është fotografuar duke marrë T.H. dhe G.K. nga aeroporti i Prishtinës.

3. Midis 24 shkurtit 2012 dhe 16 marsit 2012, A.B. kontrabandoi katër migrantë ilegalisht nga Kosova përmes Malit të Zi dhe Kroacisë për në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar. Këta migrantë u identifikuan si A.B.1., shtetas i Kosovës, i lindur më xxx (asokohe xxx vjeç), M.H, shtetas i Kosovës, i lindur më xxx (asokohe xxx), R.J., shtetas i Kosovës, i lindur më xxx (asokohe xxx vjeç), dhe A.K, shtetas i Kosovës, i lindur më xxx (asokohe xxx vjeç).

Planifikimi i operacionit të kontrabandës filloi më 24 shkurt 2012, kur A.B. mori një telefonatë nga "V", një anëtar i grupit të tij në Kosovë, i cili e informoi atë se ishin rekrutuar katër migrantë (të referuar si "katër automjete" në gjuhë të koduar) dhe ata ishin gati për t'u transportuar nga Kosova jashtë vendit. Në përgjithësi, A.B. i raportoi O.K. për operacionin. Migrantëve iu kërkua të paguajnë 2500 euro secili vetëm për transportimin e tyre nga Kosova përmes Malit të Zi, Kroacisë dhe Sllovenisë për në Itali. Ata ia lanë këtë shumë parash l. (mbiemri i paditur) në Kosovë, si siguri deri sa të përfundonte transportimi i tyre për në Europë.

Roli kryesor i A.B.'s ishte të komunikonte me transportuesit nga Kroacia në Slloveni, në Itali, fazat në të cilat krimi u konkretizua përsëri me kalimin e paligjshëm të kufijve për në shtetet e BE-së. Për ta realizuar këtë, A.B.'s diskutoi për aktivitetet në Kroaci me M.C., i cili

organizoi shoferët. A.B.'s ngarkoi me detyrë edhe G.N., e cila ofroi strehim në "Hotel Opatija" pranë Rjekës, Kroaci. M. dhe G. i raportuan edhe Z.M., menaxher i grupit kriminal në Kroaci.

Për më tepër, A.B. punoi me M.H., shtetasi i Kosovës, I.H, shtetas i Kosovës, H.B. shtetas serb i cili jetonte në Mal të Zi, dhe R.R., shtetas i Serbisë. I.H., H.B., dhe R.R. shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues nga Kosova e më tutje, ndërsa M.H. u kujdes për organizimin e punës në anën italiane. I.H., H.B. dhe R.R. i shoqëruan personalisht migrantët përgjatë udhëtimit. Ata gjithashtu hynë vetë ilegalisht në Slloveni.

Krahas kësaj, A.B. diskutoi për aktivitetet në Mal të Zi, një vend tranzit, me bashkëpunëtorin e tij të njohur si "C", i cili kontribuoi në kryerjen e veprës si shofer për grupin nga Mali i Zi në Kroaci dhe Slloveni.

Migrantët u larguan nga Kosova për në Mal të Zi më ose rreth 14 marsit 2012. Migrantët dhe transportuesit qëndruan me "C" në Mal të Zi. A.B. i tha "C" të siguronte që secili migrant t'i jepte shoferit edhe 300 euro dhe 700 euro për një tjetër bashkëpunëtor malazez në menaxhimin e transportit. Në këtë rast, bashkëpunëtor malazez në fakt mori 1.000 euro nga migrantët.

Më 15 mars 2012, nga Mali i Zi migrantët u vozitën nga dy anëtarë malazezë të grupit kriminal për në Kroaci, ku ata u akomoduan nga G.N. në "Hotel Opatija", pranë Rjekës. Në një moment, ata ndërruan veturat për t'iu shmangur autoriteteve. Pastaj ata u dërguan me varkë për në Dubrovnik, Kroaci. Gjatë rrugës A.B. mbajti kontakt me "C" dhe anëtarët e tjerë malazezë të grupit kriminal, duke u dhënë udhëzime të vazhdueshme për rrugën që duhej të ndiqnin, marrëveshjet për të hollat dhe strehimin. Varka mbërriti rreth orës 09:40 më 16 mars 2012.

Nga atje, migrantët u dërguan në drejtim të një kalimi kufitar në rajonin Ilirska Bistrica, Slloveni. A.B. i tha një shoferi tjetër nga Sllovenia t'i priste migrantët në anën tjetër të kufirit Kroaci-Slloveni. Migrantët e kaluan kufirin në këmbë në natën e 16 marsit 2012 dhe orët e hershme të 17 marsit 2012. A.B. ishte në dijeni të planeve që ata të shkonin tutje për të kaluar kufirin nga Sllovenia për në Itali, në drejtim të Gorizias, në rajonin Venezia Giulia Friuli në verilindje të Italisë.

Megjithatë, të katër migrantët, A.B., M.H., R.J., dhe A.K., si dhe transportuesit I.H., H.B., and R.R. u kapën dhe u arrestuan të gjithë nga policia sllovene në Ilirska Bistrica.

4. Midis 17 marsit 2012 dhe 28 marsit 2012, A.B. kontrabandoi tre migrantë ilegalisht nga Kosova përmes Malit të Zi dhe Kroacisë për në Slloveni, me Italinë si destinacioni i synuar. Një prej migrantëve u identifikua si B. (mbiemri i panjohur), shtetas i Kosovës.

Planifikimi për këtë operacion kontrabandimi filloi më 17 mars 2012, kur A.B. e rregulloi me një rekrutues të dërgonte një grup të ri jashtë shtetit për 2.800 euro për migrant. Rekrutuesi e informoi A.B. se ai u kishte kërkuar migrantëve 200 euro më shumë, por A.B. i tha se mund t'i mbante ato për vete.

Roli kryesor A.B. ishte të komunikonte me transportuesit nga Kosova për në Mal të Zi, nga Mali i Zi në Kroaci, nga Kroacia në Slloveni dhe në vazhdim prej andej për në Itali. Krimi u konkretizua me kalim të paligjshëm të kufirit Kroaci-Slloveni dhe hyrjen pa leje në Slloveni dhe në Itali.

Në realizimin e kontrabandimit të migrantëve, A.B. diskutoi për aktivitetet në Mal të Zi me një shok të treguar me emër dhe në Kroaci me M.C., secili prej të cilëve organizoi shoferët brenda zonave përkatëse të tij. A.B. ngarkoi me detyrë edhe G.N. dhe motrën e saj, të cilat siguruan strehim në Hotel Opatija afër Rjekës, Kroaci. M., G. dhe motra e saj i raportuan edhe Z.M., menaxher i grupit kriminal në Kroaci.

Për më tepër, A.B. punoi me I.H., dhe Sh.B., të cilët shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues nga Kosova e tutje.

Në ose rreth orës 04:00 të 22 marsit 2013, tre migrantë u larguan nga Kosova për në Mal të Zi. Ata mbërritën në Budva, Mali i Zi, rreth orës 11:00, ku u takuan nga një anëtar i grupit në Mal të Zi në stacionin e autobusëve. Ata u strehuan për natën nga një bashkëpunëtor tjetër në Mal të Zi. Të nesërmen, ata u vozitën për në Dubrovnik, Kroaci, ku ata u takuan nga një transportues tjetër. A.B. i tha bashkëpunëtorit të tij të njohur si "K.H." në Mal të Zi të sigurote që secili prej migrantëve t'i jepte shoferit nga 300 euro në Budva dhe 100 euro të tjera secili kur të mbërrinin në Dubrovnik. Grupi kaloi kufirin Kroaci-Slloveni në ose rreth datës 27 mars. Pas kësaj, ata do të udhëtonin tutje në Itali me një shofer tjetër. Megjithatë, migrantët u arrestuan nga policia sllovene dhe u deportuan në Kosovë.

PRANDAJ, për shkak të sa u deklarua më sipër, gjykata shqipton dënimin e mëposhtëm:

Duke u shpallur fajtor sipas Akuzës 2 të kontrabandës së migrantëve sipas nenit 138 paragrafi 1 të KPK-së, i akuzuari dënohet me 3 (tre) vjet burgim.

Në bazë të nenit 73 paragrafi 1 të KPK-së, koha e kaluar në paraburgim nga data 17 prill 2012 të kësaj date, do të llogaritet në dënim.

Në bazë të neneve 451, 453 dhe 450 të KPK-së, i akuzuari do të paguajë shpenzimet e procedurës penale, të vlerësuara në shumën 100 (njëqind) euro.

Çdo kërkesë-padi pasurore do të bëhet përmes gjykatave civile.

Ky Aktgjykim mund të shpallet në shtyp dhe në mediat publike.

ARSYETIM

PËRMBAJTJA

A. Hyrje.....	15
i. Juridiksioni.....	15
ii. Historia procedurale.....	16
B. Aktakuza.....	18
C. Ligji.....	32
D. Shqyrtime lidhur me vlerësimin e provave dhe dëshmive.....	33
i. Barra dhe standardi i provës.....	33
E. Marrëveshja për pranimin e fajësisë.....	34
F. Vlerësimi i provave dhe dëshmive.....	35
i. Kontrollat dhe arrestet.....	35
ii. Përgjimi dhe regjistrimi i thirrjeve telefonike.....	36
iii. Mbikëqyrja.....	93
iv. Hetimi financiar.....	93
v. Deklaratat.....	93
G. Gjetjet lidhur me përgjegjësinë e të akuzuarit	94
i. Akuzat 1 dhe 2	94
H. Dënimi	103
SHTOJCA I Dëshmitë dhe provat e Akuzës	106

Shtojca bashkëngjitur është pjesë përbërëse e këtij Aktgjykimi.

A. HYRJE

i. Juridiksioni

Gjyqtarët përbërës të këtij trupi gjykues janë kompetentë për të gjykuar këtë lëndë, sipas neneve 20, 21, 22, 25 dhe 29 të KPP-së dhe Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2013.

KPP, që hyri në fuqi më 1 janar 2013, i ri-klasifikoi gjykatat e qarkut si gjykata themelore.

Aktakuza e Prokurorit Special të EULEX-it e ngarkoi të akuzuarin me veprat e krimit të organizuar dhe kontrabandimit të migrantëve, që përfshihen në veprat e konsideruara si krime të rënda sipas nenit 22 (1.1.45) dhe (1.1.74) të KPP-së.

Krimet e dyshuara u kryen në Kosovë dhe gjetiu, prandaj juridiksioni për t'i gjykuar këto krime bie brenda kompetencës së Gjykatës Themelore të Prizrenit. Prandaj, kjo Gjykatë ka kompetencë territoriale në këtë lëndë, sipas nenit 29 të KPP-së.

PSRK ka kompetencë ekskluzive mbi veprën e krimit të organizuar, në bazë të nenit 5.1 n) të Ligjit për PSRK-në, Ligji 03/L-052 i vitit 2008.

Neni 3.2 i Ligjit nr. 03/L-053, për Juridiksionin, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë parasheh që gjyqtarët e EULEX-it të kenë juridiksion në rastet e ndjekura penalisht nga PSRK. Për rrjedhojë, Gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetencë në këtë lëndë.

ii. Historia procedurale

Më 11 dhjetor 2012, prokurori paraqiti Aktakuzën kundër O.A. dhe B.F... Më 13 shkurt 2012, prokurori paraqiti Aktakuzë të ndryshuar, ku përfshiu të pandehurin tjetër, F.A., në të njëjtën procedurë.

I akuzuari këtu u hetua në kuadrin e së njëjtës lënde, të quajtur "PINK".

Ky rast ishte hetuar nga një Ekip i Përbashkët Hetimor, i përbërë nga hetues nga Njësia e Hetimit të Krimit të Organizuar (OCIU), Policia e EULEX-it, dhe Departamenti i Krimit të Organizuar (DKO), Policia e Kosovës.

Më 10 maj të vitit 2011, PSRK mori një Kërkesë për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare (KJN) nga Prokurori Publik i Qarkut të Lubjanës, Republika e Sllovenisë⁴, në lidhje me një të dyshuar, që do të identifikohet si O.A...

Më 11 korrik 2011, prokurori shqiptoi një Aktvendim për Fillimin e Hetimit kundër O.A...

Më 11 janar 2012 dhe 11 korrik 2012, gjyqtari i procedurës paraprake miratoi vazhdimin e hetimit me gjashtë muaj të tjerë.

Më 14 dhjetor 2011, prokurori shqiptoi një Aktvendim për Zgjerimin e Hetimeve ndaj B.F.. Më 15 qershor 2012, Gjyqtari i procedurës paraprake miratoi vazhdimin e hetimit kundër të dyshuarit F. me gjashtë muaj të tjerë. Afati i hetimit ndaj tij përfundoi më 14 dhjetor të vitit 2012.

Më 20 janar 2012, prokurori shqiptoi një Aktvendim të tretë për Zgjerimin e Hetimit kundër F.A... Pas një vazhdimi, afati i hetimit kundër tij përfundonte më 20 janar 2013.

⁴ Referenca TPP-S-1 27/2010 – DŠ, datë 21 prill 2011

Më 20 janar 2012, prokurori shqiptoi një Aktvendim për Zgjerimin e Hetimit ndaj A.M., i cili më vonë u ri-identifikua si A.B...

Më 21 mars 2012, prokurori shqiptoi një Aktvendim për Zgjerimin e Hetimit ndaj A.B... Më 20 shtator 2012, gjyqtari i procedurës paraprake miratoi vazhdimin e hetimit me gjashtë muaj të tjerë. Hetimi kundër tij ishte caktuar më parë të përfundonte më 21 mars 2013, por në bazë të nenit 159 (1) të KPPK-së, Ligji 04/L-123 i vitit 2012, afati i tij përfundon më 21 mars 2014 (2 vjet nga fillimi i hetimit).

Pjesë e së njëjtës lënde ishin dhe të dyshuar të tjerë dhe hetimi ndaj tyre është në vazhdim. Më përkatës për këtë të pandehur, përveç sa më lart, janë A.C., A.M., M.B., dhe A.M., të cilët janë gjithashtu në paraburgim, si dhe N.N., i cili është paraburgosur në Kroaci sipas një kërkesë për ekstradim.

Kërkesa për ndihmë ligjore ndërkombëtare u lëshuan edhe nga prokurori i EULEX-it për Slloveninë, Kroacinë, Italinë dhe Turqinë lidhur me këtë rast, ndërsa bashkëpunimi policor ndërkombëtar ka përfshirë edhe disa vende të tjera në Europë. Në këtë fazë, përgjigjet e para janë marrë nga Sllovenia, Kroacia dhe Italia. Ende priten përgjigje të mëtejshme nga secili prej këtyre vendeve, si dhe ato të përfshira në operacionin 'Fimathu'. Më e rëndësishme lidhur me të pandehurin A.B. është përgjigja nga Kroacia.

Gjatë zhvillimit të kësaj lënde u ndërmorën gjashtë operacione në Kosovë. Këto veprime u lidhën me operacionet në vende të tjera kundër anëtarëve të tjerë të dyshuar të grupit të organizuar kriminal, në veçanti në Slloveni, Kroaci dhe Itali në vitin 2012 dhe shumë vende të tjera në kuadrin e 'operacionit Fimathu' të zhvilluar nën ombrellën e Europolit më 29 janar 2013.

Më 16 prill 2012, gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it nxori Urdhër-arrestin kundër A.B. dhe një Urdhër-kontrolli për vendbanimin e tij. Më 17 prill 2012, Ekipi i Përbashkët Hetimor

kreu të ashtu-quajturin “Operacioni PINK”, që solli arrestimin e A.B... Në të njëjtën ditë, Policia e EULEX-it dhe ajo e Kosovës kontrolluan vendbanimin e A.B., në zbatim të Urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake.

Shqyrtimi gjyqësor filloi më 28 tetor 2013 në Gjykatën Themelore në Prizren. Në fillim të shqyrtimit gjyqësor prokurori e informoi gjykatën për diskutimet ndërmjet palëve në lidhje me një marrëveshje të mundshme për pranimin e fajësisë. Me kërkesën e palëve, Trupi Gjykses e shtyu seancën kryesore, me qëllim që të vazhdoheshin këto diskutime. Më 30 tetor 2013, prokurori paraqiti në gjykatë marrëveshjen për pranimin e fajësisë, të nënshkruar nga palët.

B. AKTAKUZA

Aktakuza e ngarkoi të pandehurin me dy akuza.

Nën **Akuzën 1** (krim i organizuar) u pohua se:

O.K. dyshohet të jetë udhëheqësi i një grupi të organizuar kriminal, që organizoi transportin e paligjshëm të personave nga Turqia nëpër Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kroaci, Slloveni dhe në Itali. Ai bashkërendoi rekrutimin, transportimin, kalimin, strehimin, fshehjen dhe lëvizjet e tjera dhe pagesat nga ana e migrantëve, kryesisht me origjinë turke, nga Turqia, nëpër Kosovë, Serbi, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe Kroaci dhe më tutje në destinacionin e tyre përfundimtar në Slloveni, Itali, Hungari, Austri, Gjermani, Francë dhe vende të tjera të Europës Perëndimore. Ai mbajti kontakte me migrantët gjatë gjithë transportimit të tyre nga vendi i origjinës, dhe gjatë kalimit nëpër Ballkan, derisa ata mbërritën në destinacionin e tyre përfundimtar. Ai gjithashtu mbikëqyri dhe drejtoi aktivitetet e anëtarëve të tjerë të grupit, veçanërisht C.K., L.K., “N.” dhe A.B...

U pohua se i akuzuari ishte organizator i nivelit të mesëm në kontrabandimin e migrantëve dhe transportues i njerëzve, një kontakt kyç dhe punëtor i O. K., L.K. dhe "N".. Në veçanti, roli i tij ishte të gjente, organizonte, planifikonte dhe bashkërendonte shoferët, udhërrëfyesit dhe transportuesit e tjerë, për t'i sjellë migrantët e paligjshëm përtej kufijve shtetërorë dhe për të lehtësuar kalimin e tyre nëpër vendet e tranzitit. Ai ishte veçanërisht aktiv në pjesën e rrugës përmes Kroacisë për në Slloveni dhe Sllovenisë për në Itali, përfshirë shkuarjen deri në Trieste dhe Udine. Ai kishte marrëdhënie të forta me menaxherët e tjerë të grupit në Kroaci në veçanti, sidomos me Z.G., M.C., Z.M., G.N. dhe N.P., të cilët kishin përgjegjësi të ndryshme, përfshirë transportimin e migrantëve dhe sigurimin e akomodimit të tyre.

I.H., M.H.("B"), T.H., Sh.B, të cilët ishin rrethi i ngushtë i A.B. nga Kosova, të cilët operonin edhe në Itali, Kroaci dhe Slloveni shërbyen si transportues dhe udhërrëfyes, dhe u përfshinë edhe ata në mënyrë aktive në transferimin e pagesave ndërmjet anëtarëve të grupit kriminal në Kosovë dhe jashtë vendit.

Rruga kryesore e transitit është nga Turqia në Kosovë, përmes Malit të Zi, Kroacisë dhe Sllovenisë, me Italinë si destinacion.

Migrantët u rekrutuan nga L.K., persona të tjerë të kontaktit në Turqi, të cilët mbështeteshin tek 'N' për të menaxhuar kalimin e tyre nga Turqia, nëpër së paku tri rrugë të ndryshme kalimi, dhe më tutje për në vendet e destinacionit. "N" është i etnisë shqiptare, shtetësia e paqartë – i cili jeton në Turqi, por lëviz nëpër Turqi, Greqi, Maqedoni dhe Kosovë, ndërmjet vendeve të tjera. Ai është rekrutues dhe organizator kyç i kontrabandës.

N. mbështetet në ndihmën e A.C., pjesëmarrës kyç në grupin kriminal në Kosovë, i cili menaxhon, prokuron, siguron dhe lehtëson nxjerrjen e dokumenteve të identitetit dhe të udhëtimit dhe dokumenteve të tjera për kalimin e paligjshëm të migrantëve nëpër kufijtë e Kosovës dhe shteteve të tjera, përfshirë Kroacinë, Slloveninë, Italinë dhe Austrinë. Kjo përfshin kryesisht krijimin e letrave të ftesave nga pritës brenda Kosovës dhe vende të tjera, për të

lehtësuar hyrjen e migrantëve në ato vende. Shumica e këtyre dokumenteve janë të rreme ose përndryshe të falsifikuara, ku pritësit nuk kanë asnjë lidhje me migrantët që ata pretendohet se i ftojnë për të qëndruar, dhe paguheshin për të ndihmuar në kryerjen e veprave penale në këtë mënyrë.

Kontrabandimi i migrantëve nga Turqia për në Kosovë dhe më pas në Kroaci, Slloveni, Itali dhe vende të tjera kërkonte bashkërendimin e disa personave, që të vepronin bashkërisht si një grup i organizuar kriminal. Në të vërtetë, faktorët e mëposhtëm të njëkohshëm tregojnë se këto vepra penale janë planifikuar, orkestruar dhe mbikëqyrur nga një grup i strukturuar prej më shumë se tre personash: (i) karakteri ndërkufitar i veprave penale; (ii) rregullsia e hyrjeve dhe daljeve të grupeve të migrantëve dhe numri i madh i migrantëve të transportuar; (iii) grupi i strukturuar ka vepruar në Kosovë dhe më gjerë të paktën që prej vitit 2011; dhe (iv) shuma e parave që iu kërkua migrantëve ka sjellë përfitime të konsiderueshme financiare për anëtarët e grupit.

Nën **Akuzën 2** (kontrabanda e migrantëve) u pohua se:

Grupi i organizuar kriminal përbëhej nga të akuzuarit O.K., C.K., E.K., L.K., 'N.', A.C., N.N., M.B., A.M., I.H., M.H.("B"), T.H., Sh.B., N.P., Z.G., M.C., Z.M., G.N., dhe kryerës të tjerë të paidentifikuar, të cilët organizuan transportimin e paligjshëm të personave nga Turqia nëpër Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kroaci, Slloveni dhe deri në Itali. A.B. bashkërendoi rekrutimin, transportimin, kalimin transit, strehimin, fshehjen dhe lëvizjet e tjera dhe pagesat e migrantëve, kryesisht me origjinë turke, nga Kosova për në Kroaci dhe Slloveni dhe më tutje deri në destinacionin e tyre përfundimtar në Itali dhe vende të tjera të BE-së, përfshirë Hungarinë, Austrinë, Gjermaninë dhe vende të tjera të Europës Perëndimore

Migrantët nuk kanë viza, leje qëndrimi, leje për të qëndruar ose ndonjë leje tjetër për të hyrë ose pas kësaj për të qëndruar në territorin e Bashkimit European (BE), vendet destinacion të Sllovenisë, Italisë, Austrisë, Gjermanisë, Hungarisë ose Francës.

Ndërsa në disa raste fazat fillestare të udhëtimit mund të fillojnë me mjete ligjore, duke përdorur udhëtimet me avion ose me tren, grupi prodhon ftesa të rreme ose të falsifikuara që migrantët të hyjnë në Kosovë, Serbi dhe në vendet të tjera të transitit. Pritësit ftues nuk kanë asnjë lidhje ose familjaritet me ndonjërin prej migrantëve të cilët ata pretendohet se i kanë ftuar për të qëndruar, por më tepër dyshohet se marrin pagesë për të dhënë leje ose, më shpesh, letrat u falsifikuan plotësisht nga anëtarët e grupit kriminal, në veçanti A.C., me udhëzimet e N.

Pas hyrjes në vendet e transitit, pasaportat dhe dokumentet e tjera të udhëtimit iu morën migrantëve ose migrantët u udhëzuan t'i hidhnin vetë pasaportat e tyre ose dokumente të tilla. Pastaj ata u dërguan me automjete ose, më shpesh, u detyruan të ecin nëpër pyje, nëpër lumenj, apo toka të tjera, me qëllim që të kalonin kufijtë shtetërorë në mënyrë të paligjshme, veçanërisht në pikat e hyrjes nga Kroacia në Slloveni, nga Sllovenia në Itali, nga Serbia në Hungari dhe nga Hungaria në Austri. Shpesh migrantët u mbajtën jashtë, pavarësisht nga ora e ditës apo kushtet e motit, apo gjendja e tyre fizike. Në shumë raste, migrantët janë fëmijë, gjë që e rrit cenueshmërinë e tyre dhe rrezikun e shfrytëzimit të tyre. Në këtë mënyrë, shëndeti dhe siguria e migrantëve u vunë në rrezik.

Për më tepër, grupi kriminal shpërndau pulla dhe i udhëzoi migrantët të mbulonin refuzimet e mëparshme të lejes për të hyrë në shtetin përkatës dhe urdhrat për dëbim me pulla të tilla, me qëllim që të rritnin shanset që ata të mund të hynin në vendet transit dhe të destinacionit pa e marrë vesh autoritetet statusin e tyre të paligjshëm. Në disa raste, përgjimet zbuluan se grupi u ofroi migrantëve edhe pasaporta të reja ose të ndryshuara në vendin e origjinës, Turqi, me qëllim që ata të mund të udhëtonin pa u penguar nga regjistrimet e mëparshme në sistemet e kontrollit kufitar, që i kishin ndaluar ata të hynin sërish pas qëndrime të mëparshme të paligjshme, apo ndonjë veprimtarie tjetër kriminale.

Grupi kriminal kërkoi nga secili migrant shuma të konsiderueshme monetare, me qëllim që të organizonte dhe lehtësonte hyrjen dhe qëndrimin e tyre në vendet e transitit dhe të

destinacionit dhe t'i transportonte ata nëpër vende të shumta. Në shumicën e rasteve, këto shuma ishin zhvatje, për shembull, 2,500 euro për migrant për një kalim kufiri, pa pasur asnjë lidhje me koston mesatare të udhëtimit, akomodimit ose pritjes në vendet transit ose të destinacionit dhe pa marrë parasysh gjendjen e tyre ekonomike. Në këtë mënyrë, migrantët u shfrytëzuan nga ana e grupit kriminal, në të cilin i pandehuri **A.B.** ishte një organizator kryesor.

Aktakuza iu referua katër periudhave të caktuara gjatë të cilave prokuroria pretendon se migrantët u kontrabanduan nëpër kufij nga grupi i organizuar kriminal, që përfshinte të pandehurit.

5 shkurt 2012 deri më 25 shkurt 2012

Midis 5 shkurtit 2012 dhe 25 shkurtit 2012, i akuzuarit, si pjese e një grupi që përbëhet nga ai vetë, O.K., L.K., C.K., 'N.' (mbiemri i paditur), Z.G., M.C., G.N., I.H., A. (mbiemri i paditur), Sh.B., R.L. (nofka), kontrabandoi një grup prej gjashtë migrantësh turq ilegalisht nga Kroacia në Slloveni, me Italinë si destinacionin e synuar. Këta migrantë u identifikuan si Z.G., e lindur më xxx, A.G, i lindur më xxx, M.G., xxx, B.G, i lindur më xxx, dhe G.K, i lindur më xxx.

Planifikimi i veprës penale filloi më 5 shkurt 2012, kur i akuzuari hyri në marrëveshje me 'N', rekrutues dhe organizator kryesor në nivel ndërkombëtar, për të kontrabanduar rregullisht migrantë përmes Malit të Zi dhe Kroacisë për në Slloveni dhe Itali.⁵ Pas kësaj marrëveshjeje, i akuzuari kontaktoi me anëtarë të tjerë të grupit kriminal në ditët e ardhshme (6 deri më 19 shkurt 2012), për t'i përgatitur. Kjo përfshiu Z.G.1 në Kroaci, Sh.B. në Itali, A.⁶ në Kosovë, dhe një anëtar të paidentifikuar të grupit në Mal të Zi. Avniu do të punonte me të akuzuarin në Kosovë për të bashkërenduar shoferët, dhe Z.G.1 do të kujdesej për transportin e migrantëve në Kroaci në drejtim të Sllovenisë, ndërsa Shpejtim Bytyqi do të mbikëqyrte kalimin e tyre më tutje në Itali dhe transportimin pas kësaj.

⁵ Thirrje e përgjuar e datës 05/02/2012 ora 21:42:11

⁶ Mbiemri i paditur.

Planifikimi i operacionit u konkretizua edhe më tej më 21 shkurt 2012, kur i akuzuari hyri në marrëveshje të drejtpërdrejtë me L.K, organizatore kryesore në një nivel më lart 'N' në të njëjtin grup të organizuar kriminal, për të kontrabanduar një grup prej gjashtë personash në ditët e ardhshme.⁷ Këta gjashtë migrantë ishin shtetasit turq Z.G., A.G., M.G., B.G. dhe G.K.. L.K. e informoi të akuzuarin se migrantët përbëheshin nga një familje prej pesë të rriturish dhe një fëmije shtatë vjeçar. Ai ra dakord të organizonte kontrabandën e këtyre personave nga Zagrebi, Kroaci, për në Itali. Anëtarët e tjerë të grupit kriminal më të gjerë ndërkombëtar i kishin transportuar tashmë ata nga Turqia në Kroaci, ku do t'i merrte përsipër i akuzuari. Migrantëve u ishin kërkuar 1400 euro për person vetëm për transportimin e tyre nga Kroacia përmes Sllovenisë për në Itali.

Ndërsa L.K. ishte pika e drejtpërdrejtë dhe kryesore e kontaktit për të akuzuarin, orientimi i përgjithshëm jepej nga bashkëshorti i saj, O.K., udhëheqësi i grupit kriminal. Kjo u demonstruar kur L. i kërkoi leje O., ndërsa ishte duke folur në telefon me të akuzuarin në lidhje me operacionin e ardhshëm.⁸ Edhe i akuzuari mori udhëzime direkt nga O.K. në lidhje me kontrabandën e këtij grupi të veçantë të migrantëve. Në veçanti, O.K. ndërhyri për të kontrolluar nëse ishin rregulluar puna e shoferëve,⁹ koha dhe modalitetet e lëvizjes së migrantëve dhe hyrja në vendin e destinacionit të planifikuar (thirrjet e përgjuara në 24.02.2012, ora 00:32:46, 24.02.2012, ora 15:39:30, 25.02.2012, ora 11:27:14), dhe ku do të akomodoeshin migrantët në Rjekë dhe paratë që do të merreshin prej tyre në Kroaci (thirrjet e përgjuara më 24.02.2012, ora 17:01:28, 24.02.2012, ora 17:19:10). Edhe C.K., vëllai i O., u përfshi në marrëveshjet për kontrabandimin nga Turqia dhe komunikoi drejtpërdrejt me të akuzuarin (thirrja e përgjuar në datën 25.02.2012, ora 13:57:35).

Roli i të akuzuarit ishte të organizonte transportuesit nga Kroacia në Slloveni për në Itali, fazat vendimtare të udhëtimit të migrantëve, nisur nga fakti se këto ishin fazat kur krimi u krye nëpërmjet kalimit të paligjshëm të kufijve për në shtetet e BE-së. Për ta realizuar këtë, i

⁷ Thirrje e përgjuar e datës 21/02/2012 ora 10:19:45

⁸ Thirrje e përgjuar e datës 22/02/2012, ora 10:41:33

⁹ Thirrje e përgjuar e datës 23/02/2012 ora 16:03:39

akuzuari bashkërendoi aktivitetet në Kroaci me M.C.. M.C. organizoi shoferët direkt, duke i komunikuar shpesh të akuzuarit për të marrë udhëzime dhe për të rënë dakord për punën e parave.¹⁰ Për më tepër, i akuzuari rregulloi akomodimin e migrantëve në Opatija, Kroaci, në “Hotel Opatija”, i administruar nga G.N., një anëtare tjetër e grupit në Kroaci, e cila gjithashtu punon me M.C.¹¹

Krahas kësaj, i akuzuari bashkërendoi aktivitetet në Slloveni me bashkëpunëtorin e tij të njohur si Rako Lublan, i cili kontribuoi në kryerjen e veprës si shofer i grupit nga Sllovenia në Itali.¹²

Në mbrëmjen e datës 23 shkurt 2012, migrantët u nisën nga Zagrebi, Kroaci, për në Rjekë, Kroaci, në dy grupe. Disa prej grupit shkuan me taksì për 350 euro nga Zagrebi në Rjekë, ndërsa pjesa tjetër shkoi me autobus, pasi i akuzuari i shprehu shqetësimin e tij L.K. se ata do të kapeshin në rast se do të udhëtonin të gjithë me taksì gjatë natës. Në Rjekë ata u takuan nga shoferët e M.C., të cilët i dërguan ata në “Hotel Opatija”, të administruar nga G.N.. Migrantëve iu kërkua të paguajnë 200 euro për të qëndruar një natë. Më 24 shkurt 2012, i akuzuari bëri rregullimet e fundit me M.C. për transportin e migrantëve nga Rjeka, Kroaci, në Slloveni dhe më tej në Itali. M.C. dhe një bashkëpunëtor tjetër udhëtuan për në Rjekë që në mbrëmje, me qëllim që të ishin gati për të transportuar migrantët të nesërmen në mëngjes.

Më 25 shkurt 2012, rreth orës 05:00, M.C. dhe një shofer tjetër i morën migrantët nga Hotel Opatija. Në këtë pikë, migrantëve iu kërkua të dorëzojnë edhe 1,200 euro të tjera për shoferët (500 euro njërit, 700 euro tjetrit). Tre migrantë udhëtuan në secilin prej dy automjeteve në drejtim të kufirit kroat me Slloveninë. Në fakt kufiri u kalua në Starod, dhe migrantët hynë në Slloveni ilegalisht në ndonjë moment para orës 11:00.

Rreth orës 11:00 po atë ditë, migrantët u takuan nga një shofer tjetër në një automjet Mercedes në Račice, rajoni Ilirska Bistrica, Slloveni, i cili ishte siguruar nga i akuzuari për t’i

¹⁰ Thirrje e përgjuar e datës 24/02/2012 ora 11:28:26

¹¹ Thirrje të përgjuara të datave 24/02/2012 ora 17:08:13, 24/02/2012 ora 17:28:25, 24/02/2012 ora 20:01:24

¹² Thirrje e përgjuar e datës 24/02/2012 ora 16:05:55

dërguar ata në Itali. Plani i mëparshëm kishte qenë t'i dërgonin ata në Udine, Itali, por atë ditë shoferi i dërgoi ata drejt Triestes, Itali.

Migrantët Z.G., A.G., M.G., B.G. dhe G.K, u ndaluan të gjithë në një pikë kontrolli të policisë pasi kaluan ilegalisht në Itali ndërmjet orës 11:00 dhe 13:00, dhe u deportuan përsëri në Slloveni, ku u arrestuan nga policia sllovene në rajonin Ilirska Bistrica.¹³

Moshat dhe identitetet e migrantëve përputhen me rrethanat faktike të komunikuar në thirrjet e përgjuara të A.B., domethënë, se migrantët ishin një familje, përfshirë një fëmijë. Veçanërisht, fëmija më i vogël i grupit (B.G.) ishte vetëm xxx vjeç në kohën e ngjarjeve, madje edhe më i vogël se mosha xxx vjeç që ishte treguar. Përveç kësaj, u kontrabanduan edhe tre fëmijë të tjerë, pasi në atë kohë R.G. ishte xxx vjeç, A.G. xxx vjeç dhe M.G. xxx vjeç. Vetëm dy anëtarë të grupit ishin të rritur (Z.G., xxx, dhe G.K., xxx). Në atë kohë M.G. ishte xxx vjeç, kështu që ai mund të ishte konsideruar i rritur nga grupi kriminal, siç tregohet nga komunikimet e tyre të përgjuara. Megjithatë, sipas ligjit në fuqi, të gjithë personat nën moshën 18 vjeç janë fëmijë. Kjo është, kështu, rrethanë rënduese relevante dhe tregon cenueshmërinë e viktimave-migrante në aspektin e shfrytëzimit.

26 shkurt 2012 deri më 10 mars 2012

Midis 26 shkurtit 2012 dhe 10 marsit 2012, i Akuzuari, në kuadrin e një grupi që përbëhej prej tij, O.K., L.K., Z.G., M.C., Z.M., G.N., Sh.B., T.H. dhe H.B, kontrabanduan dy migrantë ilegalisht nga Kroacia në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar. Këta migrantë u identifikuan si H.K, shtetas turk, i lindur më xxx, dhe G.K, shtetas i Kosovës, i lindur më xxx.

Planifikimi i veprës penale filloi më 26 shkurt 2012, kur i Akuzuari pranoi të kontrabandonte G.K. nga Kosova për në Itali.¹⁴ Më tej, më 27 shkurt 2012, i Akuzuari u pajtua me vëllezërit KABATAS

¹³ Raporti 2521 i OCIU-t i Policisë së EULEX-it, datë 7/3/2012 (SPRK/in/320/OC, datë 20.3.2012).

¹⁴ Thirrje e përgjuar e datës 26/02/2012 ora 09:31:28

për të transportuar dy migrantë turq nga Zagrebi, Kroaci, për në Itali.¹⁵ Migrantët tashmë ishin transportuar nga Turqia në Kroaci nga anëtarët e tjerë të grupit të organizuar kriminal ndërkombëtar. Më 6 mars 2012, O.K. e thirri të Akuzuarin personalisht, në të cilin moment u sqarua se do të shkonte një migrant turk.¹⁶ Ky migrant që do të kontrabandohej, ishte H.K. Më vonë atë ditë, A.B ra dakord me L.K. që H. të transportohej në të njëjtën kohë me migrantin nga Kosova.¹⁷

Roli kryesor i të Akuzuarit ishte të organizonte transportuesit nga Kroacia për në Slloveni, për në Itali, fazat në të cilat krimi u konkretizua përsëri me kalimin e paligjshëm të kufijve për në shtetet e BE-së. Për ta realizuar këtë, i Akuzuari bashkërendoi aktivitetet në Kroaci me M.C., i cili organizoi shoferët. I Akuzuari ngarkoi me detyrë edhe G.N., e cila siguroi strehimin në “Hotel Opatija” pranë Rjekës, Kroaci. M. dhe G. i raportuan edhe Z.M, menaxheri i grupit kriminal në Kroaci.

Më tej, i akuzuari punoi me Sh.B., shtetas i Kosovës, T.H, shtetasi i Kosovës, dhe H.B, shtetas serb i cili jetonte në Mal të Zi, të cilët shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues. Këta tre anëtarë të grupit i shoqëruan direkt migrantët përgjatë udhëtimit. Edhe ata vetë hynë vetë ilegalisht në Slloveni.

Migrantët u nisën nga Rjeka, Kroaci, për në Slloveni më 8 mars 2012, duke kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin në rajonin Ilirska Bistrica, Slloveni, me anije në afërsi të Koperit. Ata e vazhduan udhëtimin e tyre drejt Italisë natën e 9 marsit 2012, në përpjekje për të shmangur policinë kufitare.

I Akuzuari komunikoi drejtpërdrejt me migrantët përgjatë rrugës, duke i udhëzuar ata në detaje të sakta se ku të kalojnë ndërmjet Sllovenisë dhe Italisë.¹⁸ Në këto komunikime, natyra e

¹⁵ Thirrje e përgjuar e datës 27/02/2012 ora 19:17:18

¹⁶ Thirrje e përgjuar e datës 06/03/2012 ora 14:06:24

¹⁷ Thirrje e përgjuar e datës 06/03/2012 ora 22:37:41

¹⁸ Thirrje të përgjuara të datave 08/03/2012, ora 21:11:29, 08/03/2012, ora 21:43:24, 09/03/2012, ora 21:43:24, 09/03/2012, ora 22:15:54, 09/03/2012, ora 22:21:56.

paligjshme e hyrjes është jashtëzakonisht e qartë. Për shembull, ai i udhëzon migrantët të mos e kapërcejnë një gardh, por të ecin përreth tij nëpër hekurudhë, pasi kishte qen roje.¹⁹ Më tej, ai i udhëzon migrantët të ecin nëpër pisha drejt Italisë, çka tregon se ata po hynin në Itali nëpërmjet një pike të kalimit të paligjshëm nëpër pyll.²⁰

Migrantët H.K., dhe G.K., si dhe transportuesit Sh.B., H.B., T.H., u ndaluan të gjithë në një postbllok të policisë pasi kishin kaluar ilegalisht në Itali në orët e hershme të 10 marsit 2012. Ata u deportuan përsëri në Slloveni, ku u arrestuan nga policia sllovene në rajonin Ilirska Bistrica.²¹

Nga komunikimet e përgjuara pas arrestimeve, u zbulua roli i Sh.B., H.B., T.H. si transportues të grupit kriminal.²² Ata u strehuan në një kamp për migrantët e paligjshëm në Kroaci, së bashku me dy migrantë, pasi edhe hyrja e tyre ishte pa leje. T.H. dhe G.K. u liruan dhe u deportuan në Kosovë më 15 mars 2012, ndërsa Sh.B. u lirua dhe u deportua më 16 mars 2012. Në veçanti, natyra e paligjshme e aktiviteteve të tyre në Kroaci është demonstruar nga udhëzimi që A.B. i dha Sh.B. që ky i fundit të dilte me një justifikim për praninë e tyre në Kroaci për Policinë Kufitare të Kosovës pas mbërritjes në aeroportin e Prishtinës, gjë që nuk ishte e vërtetë.²³

Mbikëqyrja fotografike e të Akuzuarit nga Policia e EULEX-it më 12 mars 2012 vërteton më tej provat e përfshirjes së tij në këtë operacion të kontrabandës, pasi ai është fotografuar duke marrë T.H. dhe G.K. nga aeroporti i Prishtinës.

24 shkurt 2012 deri më 16 mars 2012

¹⁹ Thirrje të përgjuara të datave 09/03/2012, ora 21:43:24 dhe 09/03/2012, ora 22:15:54.

²⁰ Thirrje e përgjuar më datë 09/03/2012, ora 22:21:56.

²¹ Shih raportin 3525 të NJHKO-së të policisë së EULEX-it, datë 12/3/2012 (SPRK/in/320/OC, datë 20.3.2012).

²² Thirrje të përgjuara të datave 15/03/2012, ora 10:28:04, 15/03/2012, ora 11:26:38, 15/03/2012, ora 13:36:28

²³ Thirrje e përgjuar e datës 16/03/2012 ora 22:54:43.

Midis 24 shkurtit 2012 dhe 16 marsit 2012, i Akuzuari, në kuadrin e një grupi të përbërë nga ai vetë, O.K., L.K., Z.G., M.C., Z.M., G.N., Sh.B., I.H., H.B., R.R., V.²⁴, C.²⁵, A.²⁶, I.²⁷, , kontrabanduan katër migrantë ilegalisht nga Kosova përmes Malit të Zi dhe Kroacisë në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar. Këta migrantë u identifikuan si A.B., shtetas i Kosovës, i lindur më xxx, M.H, shtetas i Kosovës, i lindur më xxx, R.J.,, shtetas i Kosovës, i lindur më xxx, dhe A.K.,, shtetas i Kosovës, i lindur më xxx.

Planifikimi i operacionit të kontrabandës filloi më 24 shkurt 2012, kur i Akuzuari mori një telefonatë nga “V”, anëtar i grupit të tij në Kosovë, që e informoi atë se ishin rekrutuar katër migrantë (të referuar si “katër automjete” në gjuhë të koduar), të gatshëm për t’u transportuar nga Kosova jashtë vendit.²⁸ Në përgjithësi, i Akuzuari i raportoi Olgun KABATASIT për operacionin.²⁹ Secilit migranti iu kërkua të paguante 2500 euro vetëm për transportimin e tyre nga Kosova përmes Malit të Zi, Kroacisë dhe Sllovenisë për në Itali.³⁰ Ata ia lanë këtë shumë ‘Idrizit’ në Kosovë, si garanci, deri sa të përfundonte transportimi i tyre për në Europë.

Roli kryesor i të Akuzuarit ishte të organizonte transportuesit nga Kroacia për në Slloveni, deri në Itali, fazat në të cilat krimi u konkretizua përsëri me kalimin e paligjshëm të kufijve për në shtetet e BE-së. Për ta realizuar këtë, i Akuzuari koordinoi aktivitetet në Kroaci me M.C., i cili organizoi shoferët. I Akuzuari ngarkoi me detyrë edhe G.N., e cila siguroi strehimin në “Hotel Opatija” pranë Rjekës, Kroaci. M. dhe G. i raportuan edhe Z.M. menaxher i grupit kriminal në Kroaci.

Më tej, i akuzuari punoi me M.H.,, shtetasi i Kosovës, I.H.,, shtetas i Kosovës, H.B.,, shtetas serb i cili jetonte në Mal të Zi, dhe R.R.,, shtetas i Serbisë. I.H., H.B., dhe R.R. shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues nga Kosova e më tutje, ndërsa M.H. u kujdes për organizimin e punës në anën

²⁴ Last name not known

²⁵ Last name not known

²⁶ Last name not known

²⁷ Last name not known

²⁸ Thirrje e përgjuar e datës 24/02/2012, ora 18:05:10.

²⁹ Thirrje e përgjuar e datës 14/03/2012, ora 17:12:39.

³⁰ Thirrje e përgjuar e datës 14/03/2012, ora 19:13:14.

italiane. I.H., H.B., R.R. i shoqëruan personalisht migrantët përgjatë udhëtimit. Ata gjithashtu hynë vetë ilegalisht në Slloveni.

Përveç kësaj, i Akuzuari koordinoi aktivitetet në Mal të Zi, vend transit, me bashkëpunëtorin e tij të njohur si “C.”, i cili kontribuoi në kryerjen e veprës si shofer i grupit nga Mali i Zi për në Kroaci dhe Slloveni.

Migrantët u larguan nga Kosova për në Mal të Zi më ose rreth 14 marsit 2012. Migrantët dhe transportuesit qëndruan me “C.” në Mal të Zi. I Akuzuari e udhëzoi “C.” të siguronte që secili migrant t’i jepte 300 euro të tjera shoferit dhe 700 euro të tjera një bashkëpunëtori tjetër malazez që menaxhonte transportin.³¹ Në këtë rast, bashkëpunëtori malazez në fakt mori 1.000 euro nga migrantët.³²

Nga Mali i Zi, më 15 mars 2012, migrantët u dërguan me automjet nga dy anëtarët malazezë të grupit kriminal në Kroaci, ku ata u strehuan nga G.N. në “Hotel Opatija”, pranë Rjekës.³³ Në një moment, ata ndërruan veturat për t’iu shmangur autoriteteve.³⁴ Pastaj ata u dërguan me anije në Dubrovnik, Kroaci.³⁵ Përgjatë rrugës, i Akuzuari mbajti kontakte me “C” dhe anëtarët e tjerë malazezë të grupit kriminal, duke dhënë udhëzime dhe orientime të vazhdueshme se në cilën rrugë të shkonin, si të vepronin lidhur me paratë dhe strehimin.³⁶ Varka mbërriti rreth orës 09:40 më 16 mars 2012.³⁷

Nga atje, migrantët u dërguan në drejtim të kalimit kufitar në rajonin Ilirska Bistrica, Slloveni.³⁸ Një shofer tjetër nga Sllovenia ishte udhëzuar nga i Akuzuari t’i priste migrantët në anën tjetër të kufirit Kroaci-Slloveni. Migrantët e kaluan kufirin në këmbë në natën e 16 marsit 2012 dhe

³¹ Thirrje e përgjuar e datës 14/03/2012, ora 17:25:59

³² Thirrje e përgjuar e datës 14/03/2012, ora 19:05:26

³³ Thirrje e përgjuar e datës 14/03/2012, ora 17:12:39

³⁴ Thirrje e përgjuar e datës 15/03/2012, ora 23:17:21

³⁵ Thirrje e përgjuar e datës 15/03/2012, ora 19:23:29

³⁶ P.sh. thirrja e përgjuar e datës 15/03/2012, ora 23:02:18.

³⁷ Thirrje e përgjuar e datës 16/03/2012, ora 09:42:06.

³⁸ Thirrje e përgjuar e datës 17/03/2012, ora 05:06:20.

orët e hershme të 17 marsit 2012.³⁹ I Akuzuari kishte bërë plane që ata të vazhdonin më tutje e të kalonin kufirin nga Sllovenia për në Itali, në drejtim të Gorizias, në rajonin Fruili Venezia Giulia në verilindje të Italisë.⁴⁰

Mirëpo të katër migrantët, A.B., M.H., R.J., dhe A.K., dhe transportuesit, I.H., H.B., dhe R.R., u kapën të gjithë nga policia sllovene në Ilirska Bistrica dhe u arrestuan.⁴¹

17 mars 2012 deri më 28 mars 2012

Midis 17 marsit 2012 dhe 28 marsit 2012, i Akuzuari, në kuadrin e një grupi të përbërë nga ai vetë, Z.G., M.C., Z.M., N.P., G.N., Sh.B., I.H., H.B., N.⁴² dhe nje malazez i identifikuar si “K. H.”, kontrabanduan tre migrantë ilegalisht nga Kosova përmes Malit të Zi dhe Kroacisë për në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar. Njëri prej migrantëve u identifikua si B.⁴³, shtetas i Kosovës.

Planifikimi për këtë operacion kontrabande filloi më 17 mars 2012, kur i akuzuari e rregulloi me një rekrutues të dërgonte një grup të ri jashtë vendit për 2.800 euro për migrant⁴⁴. Rekrutuesi e informoi të Akuzuarin se ai i kishte kërkuar çdo migranti 200 euro më shumë, por i Akuzuari i tha se ai mund t’i mbante për vete.

Roli kryesor i të akuzuarit ishte të organizonte transportuesit nga Kosova në Mal të Zi, nga Mali i Zi në Kroaci, nga Kroacia në Slloveni dhe prej andej në Itali. Krimi u konkretizua me kalim të paligjshëm të kufirit Kroaci - Slloveni dhe hyrjen pa leje në Slloveni dhe Itali.

³⁹ Thirrje e përgjuar e datës 17/03/2012, ora 02:26:11.

⁴⁰ Thirrje e përgjuar e datës 14/03/2012, ora 19:05:26.

⁴¹ Shih raportin 3520 të NJHKO-së të policisë së EULEX-it (SPRK/in/321/OC, datë 20.3.2012).

⁴² Mbiemri i paditur.

⁴³ Mbiemri i paditur.

⁴⁴ Thirrje e përgjuar e datës 17/03/2012, ora 20:00:50

Në kryerjen e kontrabandës së migrantëve, i akuzuari i koordinoi aktivitetet në Mal të Zi me një bashkëpunëtor të quajtur N⁴⁵ dhe në Kroaci me M.C,⁴⁶ secili prej të cilëve organizoi shoferët brenda zonës së vet përkatëse. I Akuzuari ngarkoi me detyrë edhe G.N. dhe motrën e saj, të cilat siguruan strehimin në “Hotel Opatija” pranë Rjekës, Kroaci. M., G dhe motra e saj i raportuan edhe Z.M., menaxher i grupit kriminal në Kroaci.⁴⁷

Më tej, i akuzuari punoi me I.H., dhe Sh.B., të cilët shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues nga Kosova e tutje.

Në ose rreth orës 04:00 të 22 marsit 2013, të tre migrantët u nisën nga Kosova për në Mal të Zi.⁴⁸ Rreth orës 11:00, ata mbërritën në Budva, Mali i Zi, ku u takuan nga një anëtar i grupit në Mal të Zi në stacionin e autobusëve. Gjatë natës ata u strehuan nga një tjetër bashkëpunëtor malazez. Të nesërmen ata u dërguan me automjet në Dubrovnik, Kroaci, ku u takuan nga një transportues tjetër.⁴⁹ I akuzuari e udhëzoi bashkëpunëtorin e tij të njohur si “K H.” në Mal të Zi të siguronte që secili migrant t’i jepte shoferit 300 euro në Budva dhe 100 euro të tjera kur të mbërrinin në Dubrovnik.⁵⁰ Grupi e kaloi kufirin Kroaci - Slloveni më ose rreth 27 marsit 2013.⁵¹ Pas kësaj, ata do të udhëtonin më tutje në Itali me një tjetër shofer.⁵²

Më 30 tetor 2013, prokurori e ndryshoi Akuzën 2 të Aktakuzës, duke e ngarkuar të akuzuarin sipas nenit 138 paragrafi 1 të KPK-së.

⁴⁵ Thirrje e përgjuar e datës 21/03/2012, ora 18:44:50.

⁴⁶ Thirrje e përgjuar e datës 21/03/2012, ora 11:31:56.

⁴⁷ Thirrje e përgjuar e datës 27/03/2012, ora 18:47:34.

⁴⁸ Thirrje e përgjuar e datës 21/03/2012, ora 18:23:27.

⁴⁹ Thirrje e përgjuar e datës 18/03/2012, ora 16:20:23.

⁵⁰ Thirrje e përgjuar e datës 23/03/2012, ora 19:44:42.

⁵¹ Thirrje e përgjuar e datës 27/03/2012, ora 18:46:01.

⁵² Thirrje e përgjuar e datës 22/03/2012, ora 18:44:50.

C. LIGJI

Në Akuzën 1, i akuzuari u akuzua për krim të organizuar, në shkelje të nenit 274 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së.

Neni 274 i KPK-së parashikon:

(1) Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet..

(2) Kushdo që aktivisht merr pjesë në aktivitete kriminale ose në aktivitete të tjera të një grupi kriminal të organizuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuojë kryerjes së krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar dënohet me burgim së paku pesë vjet.

(3) Kushdo që organizon, formon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar dënohet me gjobën deri në 500.000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

Në Akuzën 2, të ndryshuar, i akuzuari u akuzua për kontrabandim të migrantëve, në shkelje të nenit 138 paragrafët 1 të Kodit Penal të Kosovës.

Neni 138 paragrafi 1 i KPK-së parashikon:

Kushdo që merret me trafikimin të migrantëve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

D. VLERËSIMET LIDHUR ME PROVAT DHE DËSHMITË

I. Barra dhe standardi i provës

Neni 6 (2) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm "KEDNJ"), Kushtetuta e Kosovës dhe neni 3 (1) i KPP-së parashikojnë prezumimin e pafajësisë që gëzojnë të akuzuarit. Ky prezumim vendos mbi Akuzën barrën e vërtetimit të fajësisë së të akuzuarit, një barrë e cila i mbetet Akuzës gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor.

Neni 370 (7) i KPP-së përcakton se *'Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara'*. Prandaj, Trupi Gjyqësor duhet të përcaktojë në lidhje me secilën prej akuzave të ngritura kundër secilit prej të akuzuarve, nëse ai është i kënaqur mbi bazën e tërë provave, në mënyrë që jetë i sigurt se çdo element i atij krimi është vërtetuar. Çdo dyshim duhet të zgjidhet në dobi të të akuzuarit.

Në bazë të nenit 7 (1), (2) të KPP-së, trupi gjyqësor *'...detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm'* dhe *'...detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në ... favor ...'*

E. MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË

Më 30 tetor 2013, palët paraqitën në gjykatë një marrëveshje me shkrim për pranimin e fajësisë, ku ishte rënë dakord që i akuzuari do ta pranonte fajësinë për Akuzën 2 të veprës së kontrabandës së migrantëve, në shkelje të nenit 138 paragrafi 1 të KPK-së. Akuza 1 e Aktakuzës u tërhoq.

Mundësia e një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë u përshkrua në gjykatë në mëngjesin e 28 tetorit 2013, në fillim të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore të Prizrenit. Në këto

rrethana, Aktakuza nuk u lexua në gjykatë nga prokurori dhe çështja u shty për një periudhë prej dy ditësh, për të siguruar që të gjitha palët të kishin kohë të informoheshin plotësisht për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe me qëllim që çdo kusht para marrëveshjes të mund të përmbushej sipas kërkesave të të gjitha palëve.

Për rrjedhojë, u zbatua marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe çështja vazhdoi për përfundim më 30 tetor 2013.

F. PROVAT DHE DËSHMITË

i. Kontrollat dhe provat e sekuestruara

Më 16 prill 2012, gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it shqiptoi Urdhrin për Arrestimin e A.B. dhe Urdhrin për Kontrollin e vendbanimit të tij. Më 17 prill 2012, Ekipi i Përbashkët Hetimor zhvilloi të ashtuquajturin “Operacion PINK”, që solli arrestimin e A.B.. Të njëjtën ditë Policia e EULEX-it dhe Policia e Kosovës kryen një kontroll në vendbanimin e A.B., sipas Urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake.⁵³

Gjatë atij kontrolli, policia sekuestroi 5 aparate telefoni, 3 karta SIM dhe një kompjuter.

a. Aparatet telefonike

1. Samsung, pa numër serik të dukshëm
2. Nokia RM-240, model 6500, Numri IMEI: xxx
3. Samsung T-Mobile, Numri IMEI: xxx
4. Nokia X2-00, Numri IMEI: xxx
5. Nokia model 1208, Numri IMEI: xxx

⁵³ Raport i Arrestimit dhe Kontrollit të Shtëpisë, datë 17 prill 2012.

b. Kartat SIM

1. VALA, numri serik: xxx
2. IPKO, numri serik: xxx
3. IPKO, numri serik: xxx

Këto sende iu nënshtruan analizës forensike.⁵⁴

Gjetjet lidhur me provat telefonike

Trupi gjykues gjen se telefonat numër xxx, xxx, xxx, xxx dhe xxx ishin në posedim dhe përdorim të të akuzuarit në kohët materiale.

ii. **Përgjimi dhe regjistrimi i thirrjeve telefonike**⁵⁵

Më 17 janar 2012, Ekipi i Përbashkët Hetimor mori informacion nga policia sllovene në lidhje me një anëtar të grupit kriminal të identifikuar gjatë hetimeve të saj. I dyshuari u quajt A.M. dhe u dha informacion për tre numra telefoni IPKO që mendohej se përdroreshin nga ai: xxx, xxx, dhe xxx.

Më 31 janar 2012, gjyqtari i procedurës paraprake lëshoi një urdhër për përgjimin e telekomunikimeve kundër të dyshuarit atëherë të njohur si A.M..

Më 15 mars 2012, Policia e EULEX-it e identifikoi sërish të dyshuarin si A.B., në vijim të informatave të marra nga policia kroate. Ky identifikim u mbështet nga përgjimet telefonike. Më pas kundër të pandehurit nën emrin A.B., u lëshuan urdhra të tjerë për përgjim.

⁵⁴ Raport i Policisë së EULEX-it 4742, datë 4 tetor 2012, me titull 'Analizë pas ekzaminimit forensik, (SPRK/in/OC/1156, datë 09.10.2012), A.B. Dosja V; shih gjithashtu Raportin e Ekzaminimit Forensik të EULEX-it, datë 30.7.2012, A.B., Dosja V, Tab. 13.

⁵⁵ Raport i Policisë së EULEX-it 5638, datë 10.04.2013 (SPRK/in/324/OC, datë 11.4.2012), PINK/Ardian Bytyqi, Dosja VI, f. 3-4.

Përgjimet

Prokuroria u mbështet në përmbledhjet e bisedave të përgjuara, krahas rasteve kur jepet fjalë për fjalë një pjesë e bisedës së përgjuar. Trupi Gjykses gjen se përmbledhjet e bisedave të përgjuara janë të sakta.

5 shkurt deri më 25 shkurt 2012

Gjatë kësaj periudhe përgjimi, u vërtetua se i akuzuari u përfshi në kontrabandimin e Z.G., shtetas turk, A.G., shtetas turk, M.G, shtetas turk, R.G., shtetas turk, B.G., shtetas turk, dhe G.K, shtetas turk, nga Kroacia përmes Sllovenisë për në Itali.

5 shkurt 2012

Në orën 21:42:11, i akuzuari (xxx) thirri "N." (xxx)⁵⁶

I akuzuari: a ka ndonjë punë?

N.: Erdhi njëri. Ai është në Kroaci. ...është dhe një tjetër por ai nuk ka aq para ...

I akuzuari: dhe ku është ai?

N.: Janë të dy në Zagreb

I akuzuari: Dërgoji atje poshtë, kupton? Dërgoji poshtë sepse është – 20. Është -14, -15, shumë ftohtë. ...Vetëm dy janë?

N.: jo, jo. Do të vinë dhe dy të tjerëti merri këta dhe mbaro me ta...

..

I akuzuari: Do t'i them asaj që këta janë të mitë, mos u brengos për këtë, ok?

N.: Ok, po

⁵⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 20-24

6 shkurt 2012

Në orën 14:02:11 i akuzuari (xxx) mori një SMS nga një PMP⁵⁷ në Mal të Zi (xxx)⁵⁸ në të cilin thuhej:

“...sa është çmimi i automjetit?”

Në orën 14:05:00 i akuzuari (xxx) i dërgoi një SMS një PMP-je në Mal të Zi (xxx)⁵⁹, ku thuhej:

“...shoku im i cili do të vozisë kerrin nuk dha para, ai i mori ato – kjo nuk është mirë”

10 shkurt 2012

Në orën 18:35:29 i akuzuari (xxx) thirri Z.G.1 (xxx)⁶⁰

Z: në majë ka borë dhe tufan...ju ndihmoftë zoti, e kupton?

I akuzuari: ...çdo gjë është bllokuar këtu ...

Z: ...ka borë gjithandej përreth, por ne nuk kemi borë në Rijeckë, e kupton?

Kjo bisedë dyshohet se është e koduar, ku me dëborë i referohen operacioneve dhe arrestimeve të policisë.

16 shkurt 2012

⁵⁷ Person mashkull i pa identifikuar

⁵⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 39-40

⁵⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 41-42

⁶⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 61-64

Në orën 11:44:52, Isuf Hajdari përdori telefonin e të akuzuarit (xxx) dhe thirri Shpejtim Bytyqin (xxx)⁶¹

I.H.: Jam këtu me kunatin tënd nga Orllati dhe është një person i cili është i interesuar të shkojë në Itali, të vijë me ju.

Sh.: po

I.H.:: Nuk e di a ke folur me të...

Sh: Aha

I.H.:: I treguam atij personi cdo gjë. Nëse pranonte. Por po mendonim të të tregonim të dilni atje sepse kemi vozitës deri në Gorezi. Afër Triestes në Gorezi. I tregova atij se ai mund të shkojë jashtë shtetit nëse ju mund të shkonit atje dhe ta merrni këtë person dhe nëse jo, më mirë të mos shkoni sepse do ta kapë policia atje në Udine në Gorezi....prandaj po të pyes nëse mund ta bësh brenda një jave.

Në orën 11:50:29 *I.H.:* përdori telefonin e të akuzuarit (xxx) dhe thirri Sh.B. (xxx)⁶²

...

I.H.:: Më trego, a mund të vini ta merrni atë në Gorezi?

...

Sh.:: Kur po planifikon të niset?

I.H.:: Për rreth dy javë...

18 shkurt 2012

⁶¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. t VII, f. 84-87

⁶² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 88-91

Në orën 17:55:34, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP në Mal të Zi (xxx)⁶³

I akuzuari: Kam gjetur një person këtu dhe më duhet të gjej dy ose tre të tjerë ... Bisedova me një person sot dhe ai përfundoi gjithçka atje, dhe më kërkoi numrin tënd të telefonit dhe ia dhashë, sepse ai i la të gjithë numrat këtu dhe ai i la të gjithë numrat këtu dhe më kërkoi numrin tënd të telefonit në Turqi, dhe tha se do të rregullojë diçka...

Bashkëpunëtori: ...lidhur me njerëzit, sapo t'i gjesh fillo menjëherë dhe unë do të të pres, vetëm më vër në dijeni një ditë para se të fillosh që të të pres ...

19 shkurt 2012

Në orën 10:16:36 i akuzuari (xxx) thirri "A" (xxx)⁶⁴

A: ...I thashë atij t'i thotë atij personi çfarë don të bësh, a do të takohemi diku sot sepse ai shkon së shpejti...E thirra mbrëmë dhe ai më tha betohem A. i thashë atij dhe ai më tha se duhet të ecë shumë, është e sigurt por nuk e di se kur ...

22 shkurt 2012

Në orën 10:14:33 i akuzuari (xxx) u thirr nga L.K. (xxx)⁶⁵

L.: Sapo dërgova 3 njerëz në Itali...kam një familje tjetër...a mendon se mund t'i dërgosh ti atje?

I akuzuari: A kanë ndonjë fëmijë ose grua, çfarë janë?

⁶³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 104-107

⁶⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 115-116

⁶⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. nit VII, f. 143-151

L.: ...kanë vetëm një fëmijë, ai është 7 vjeç

I akuzuari: ...nuk marr njerëz me fëmijë ...nuk guxoj të marr fëmijë, a më kupton?

...

L.:: Ok por me ta ti ke shtatë vjeç, ai nuk është i vogël kupton? Ai nuk qan, nuk është i vogël.

I akuzuari: Sa vjeç janë të familjes?

L.:: pesë të rritur dhe një fëmijë shtatë vjeç...ti e di se shumicën e herëve marrim familje, janë para të mira prej tyre.

I akuzuari: Ku janë ata, në Kroaci kështu?

L.:: Zagreb

22 shkurt 2012

Në orën 10:31:28 i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)⁶⁶

I akuzuari e pyet xxx nëse ai është i lirë të shkojë në Slavonski Brod. xxx i përgjigjet dhe i thotë se është i lirë të pasnesërmen.

Në orën 10:41:33 i akuzuari (xxx) kontaktoi me L.K. në turqishte (xxx)⁶⁷

⁶⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 152-153

⁶⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 154-157

I akuzuari: Thirra shokun tim atje, ai tha se mund ta mbarojë atë të premtën, por nuk mund të mbarojë çdo gjë menjëherë, është vetëm një vend, nuk duhet të ketë më shumë e kupton, ti e di se ata mund të kalojnë për shembull 3 menjëherë pastaj dy të tjerët

L.:: (bën një pyetje në gjuhën turke në sfond) po, ai tha po

Në orën 15:40:37 i akuzuari (xxx) u thirr nga një PMP në Turqi në (xxx)⁶⁸

Bashkëpunëtori: Çfarë ndodhi? A ka ndonjë të re?

I akuzuari: Nuk mund të bëj gjë deri të premtën, sepse ata kanë fëmijë me vete. A kupton? Do ta kryej të premtën, pasnesër.

Bashkëpunëtori: Të premtën në mëngjes?

I akuzuari: të premtën mëngjes në 4 të mëngjesit.

Bashkëpunëtori: OK.

23 shkurt 2012

Në orën 09:45:16, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)⁶⁹

I akuzuari e pyet PMP-në⁷⁰ sa kohë do t'i duhen atij të arrijë deri në atë zonë, duke i thënë "duhet të di nëse do të jesh atje apo jo sepse ai e ka sendin me vete". PMP e pyet se sa gjëra ka ai. I akuzuari i përgjigjet "si zakonisht [si në origjinal] është një veturë."

⁶⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 160-161

⁶⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 162-163

⁷⁰ Person Mashkull i Panjohur

Në orën 10:39:44, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx.)⁷¹

I akuzuari: “atje poshtë duke të pritur ty, shko atje dhe ata do të të japin 500 euro nëse don atje ose kur të vish këtu ...janë tre persona”.

Në orën 15:47:02, i akuzuari (xxx) kontaktoi me L.K. (xxx)⁷²

I akuzuari:.. është një burrë, grua dhe fëmijë

L.: po

I akuzuari: Dhe tre të rriturit?

L.: pesë të rritur dhe një fëmijë gjithsej

I akuzuari: domethënë pesë të rritur dhe një fëmijë, një grua dhe vetëm një fëmijë

L.: po, ai është shtatë

Në orën 16:03:39 i akuzuari (xxx) u kontaktua nga O.K. (xxx)⁷³

Bashkëpunëtori: A bisedove me gruan time?

I akuzuari: do të bisedojë me vozitësin sot.

Në orën 16:22:04, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga L.K. (xxx)⁷⁴

⁷¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 164-165

⁷² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 166-169

⁷³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 170-171

L.: Thirra sepse thirri O. dhe tha se ai e di për këtë, ti the se thirri dikush, ishte O. ai që thirri ...nëse i dërgon ata, unë do të të jap 1500 euro menjëherë kur ata të jenë në rrugë

I akuzuari: Ok, nuk ka problem, më dëgjo Luljeta, ata janë në Zagreb tani

L.:: po

I akuzuari: A mund të shkojnë në Rjekë në Opatija?...unë punoj vetëm në Rjekë...dhe Opatija, Trieste nga këtu është 32 km, a mund t'i vësh ata sonte në autobus?

L.:: po

I akuzuari: autobusi do të jetë në Rjekë, distanca nga atje në Zagreb është 150km, më thirr kur të mbërrijnë në Rjeka...pastaj do të shkojë një grua dhe do të kujdeset për ta

L.:: kur duhet të nisen, tani apo më vonë?

I akuzuari: në mëngjes në orën 8 ose 9...kur të mbërrijnë atëherë duhet të marrin një taksi për në Opatija kushton vetëm 2 euro, pastaj ata do të shkojnë me një grua në banesën e saj që është afër kufirit pastaj vozitësit do t'i dërgojnë ata ... ti e di për paratë, mos u vono OK.

L.: a duhet t'i dërgoj të gjithë ata atje?

I akuzuari: po të gjithë sepse nuk mund t'i marr të gjithë në një kerr, njeri, pesë të rritur me një fëmijë

⁷⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 172-177

L.: Po të kesh dyshime mund t'i mbash peng dy prej tyre deri sa të të dërgoj paratë

Në orën 16:47:09, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PMP në (xxx)⁷⁵

Bashkëpunëtori: Pronari i familjes është këtu...a ka ndonjë ecje?

I akuzuari: Jo

Bashkëpunëtori: ...Çfarë ore është nisja për në Itali?

I akuzuari: 4 e mëngjesit për në Itali. Ata do të mbërrijnë për 3 -4 orë në Itali.

Në orën 16:54:16, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga O.K. (xxx)⁷⁶

O.:: Familja sonte në Rjekë?

I akuzuari: Çfarë?

O.:: A po i dërgon ata në shtëpi?

I akuzuari: Ka një shtëpi në Rjekë

O.: N. e njuh atë gruan...në shtëpinë në Opatija

I akuzuari: Kam dikë në shtëpi

⁷⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 190-192

⁷⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 178-179

Në orën 17:15:33, i akuzuari (xxx) kontaktoi me L.K. (xxx)⁷⁷

Luljeta: tani ata po nisen për në Rjekë

I akuzuari: do të thërras pronaren dhe atje nuk do të ketë problem

Në orën 17:20:21, i akuzuari (xxx) kontaktoi me G.N. (xxx)⁷⁸

I akuzuari: "mos i thuaj njeriu që ata janë atje, vetëm nëse të thërrasin nga Turqia".

Në orën 18:59:01, i akuzuari (xxx) kontaktoi me L.K. (xxx)⁷⁹

I akuzuari i thotë L. ta thërrasë atë kur ata të mbërrijnë në hotel Opatija

Në orën 20:49:09 i akuzuari (xxx) u kontaktua nga L.K. (xxx)⁸⁰

L.: unë do t'i fus ata në një taksì, do të duhet të paguaj 350 euro për një taksì, a është e sigurt se ata do të kalojnë nesër mbrëma?

I akuzuari: mos i dërgo me taksì ata do t'i kapin, është vonë, më dëgjon, a kupton...

L.: Pra është më mirë nëse ata nisen në mëngjes

I akuzuari: po nesër midis orës 10 ose 11 nuk është problem...kush kërkon 250 euro?

⁷⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. II, f. 180-181

⁷⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 184-185

⁷⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 193-194

⁸⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 199-204

L.:: kështu u thanë atyre kur të nisen nëse don ose në Itali ose Rjekë, unë mund të të sjell 2000 euro.

I akuzuari: ...me N. ne mbaruam mijëra prej tyre dhe nuk patëm kurrë probleme ...

L.:: Për mua është më e lehtë se pasagjerët kanë 2000 euro...

I akuzuari:...futi në një autobus ...

L.:: sa do të marrësh për të kaluar? ... unë do të të sjell tetë persona dhe dy të tjerë nga Bosnja mbërritën dhe ti vendos sa do të marrësh ...

I akuzuari: Ti dërgoji në Rjekë, lëri atje, unë do të mbaroj tre një herë dhe tre një herë edhe po të jenë dhjetë, e di çfarë duhet të bëj...ok Luljeta, pra 1500 euro 200 ose sa të kenë. Do të të tregoj se kujt duhet t'ia japësh kur ata të shkojnë në Slloveni...

Në orën 21:12:49, i akuzuari (xxx) mori një SMS nga L.K. (xxx)⁸¹ në të cilin thuhej:

“Ata i kanë dërguar ata rrugës; kur të mbërrijnë do të të njoftoj!”

24 shkurt 2012

Në orën 10:55:41, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP në Bosnjë dhe Hercegovinë (xxx)⁸²

I akuzuari po bisedon me një PMP në Bosnjë & Hercegovinë. Personi me të cilin ai po bisedon i kërkon të akuzuarit t'i dërgojë atij 200 ose 300 euro dhe thotë se pastaj ai do të shkojë po ndonjë problem. I akuzuari e informon PMP-në se njerëzit që ai do të marrë, i kanë paratë me vete. I akuzuari i kërkon PMP-së të dërgojë vozitësin dhe se ai do t'i

⁸¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 205-206

⁸² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 211-212

udhëzojë personat t'i japin atij 200 euro.

Në orën 11:28:26, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)⁸³

M.C. e informon të akuzuarin se ai do të “mbarojë nesër me tre prej personave kur unë të shkoj në orën 5 të mëngjesit në Rjekë”, në shkëmbim të 500 eurove tani dhe më shumë më vonë sepse ai duhet t'ia japë paratë një personi tjetër. I akuzuari pajtohet.

Në orën 11:35:21, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga L.K. (xxx)⁸⁴

L.K. e informoi të akuzuarin se të 8 personat kishin mbërritur. I akuzuari e këshillon atë se 4 prej migrantëve duhet të nisen në 4 të mëngjesit dhe burri, bashkëshortja dhe fëmija duhet të nisen në mbrëmje “me qëllim që të mos ecin në këmbë”.

Në orën 12:32:46, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga O.K. (xxx)⁸⁵

O.K. ata janë një familje e tërë ... gjysma do të shkojë sonte. Gjysma tjetër do të shkojë nesër në mëngjes at 4.

Në orën 15:39:30, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga O.K. (xxx)⁸⁶

O.K. Çfarë ore do të nisen?

I akuzuari: Nesër në mëngjes në orën 4

O: Të gjithë do të nisen në orën 4

⁸³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 213-214

⁸⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 217-218

⁸⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 219-220

⁸⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 221-222

I akuzuari: Të gjithë do të shkojnë në 4 të mëngjesit. Ata do të mbërrinë në Itali në 8-9, të nesërmen në mëngjes.

Në orën 15:43:35, i akuzuari (xxx) kontaktoi me L.K. (xxx)⁸⁷

L.K. i tregon të akuzuarit se burri, bashkëshortja dhe fëmija shkuan me automjet por të tjerët shkuan me autobus që të mos paguanin 350 euro sepse ishte vetëm një automjet dhe në automjet nuk kishte vend për të gjithë.

Në orën 15:51:27 i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)⁸⁸

M.C. i tregon të akuzuarit se ai do të mbërrijë atje në orën 5 të mëngjesit. M.C. e pyet të akuzuarin nëse ai do ta marrë pagesën prej 500 eurosh menjëherë pasi ata të takohen dhe pjesën tjetër t'ia japë një shoku. I akuzuari i tregon atij se ai do të takohet nga vozitësi dhe se migrantët do të jepnin paratë nga të cilat ai do të marrë 600 euro për tre persona.

Në orën 16:05:55, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një bashkëpunëtor, "R.L", (xxx)⁸⁹

I Akuzuari i tregon R.L se ai ka tre shokë të cilët kanë 1000 euro me vete dhe të marrë 500 euro për veten e tij dhe 500 të tjerat t'ia japë atij. Vozitësi e paralajmëron të akuzuarin se ai u ndalua nga policia herën e fundit që kaloi kufirin për në Trieste. I akuzuari e udhëzon atë të mos përdorë rrugën e Triestes por të përdorë "atë të Gorizias afër Goricës".⁹⁰

⁸⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 223-224

⁸⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A.VII,, f. 225-226

⁸⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 227-228

⁹⁰ Gorizia është qytet në verilindje të Italisë, në kufi me Slloveninë afër Nova Gorica.

Në orën 17:01:28, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga O.K. (xxx)⁹¹

O.:: Banesa është 200 euro për 1 ditë qëndrimi për familjen. Pse?

I akuzuari: Pse? Sa para mori ai nga pronari i banesës?

O.: Shtëpia në Opatija. 1 ditë është 200 euros.

Në orën 17:08:13, i akuzuari (xxx) kontaktoi me G.N. (xxx)⁹²

I akuzuari e pyet G.N. nëse ata ia dhanë asaj paratë. Ajo u përgjigj se ata nuk ia kishin dhënë paratë akoma, por i kishin thënë se do t'i jepnin 200 euro, por ajo u kishte thënë se 160 euro do të mjaftonin.

Në orën 17:19:10, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga O.K. (xxx)⁹³

O.:: Shtëpia në Opatija...ajo gruaja po shkakton problem.

I akuzuari: Çfarë problemi?

*O.: Paratë janë problem. Një herë ajo tha 100 euro, tani thotë 200. Pse është 200 tani?
Fol me të.*

Në orën 17:28:25, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga G.N. (xxx)⁹⁴

⁹¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 232-233

⁹² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 234-235

⁹³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 236-237

I akuzuari e pyet G.N. çfarë ndodhi dhe sa para kishte marrë. Ajo i përgjigjet se ata nuk i kishin dhënë gjë akoma dhe se O. i detyrohej asaj edhe 300 euro dhe NAIMI i detyrohej 1000 euro. Ajo premtoi t'i dërgonte të akuzuarit pjesën e tij të hënën.

Në orën 17:59:04, i akuzuari (xxx) kontaktoi me L.K. (xxx)⁹⁵

L.K. i tregon të akuzuarit se bashkëshorti i saj kishte qenë ai që e kishte thirrur atë në turqishte. I akuzuari sqaroi se migrantët duhej të paguanin 20 euro nata për hotelin në Opatija. Më tej ai shtoi se ata do të largoheshin në 4 ose 5 të nesërmen në mëngjes.

Në orën 18:01:45, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)⁹⁶

I akuzuari flet me M.C. dhe e pyet nëse ai është nisur. M.C. i përgjigjet se do të niset në orën 10 atë mbrëmje për të mbërritur në Rjekë në 5 të mëngjesit.

Në orën 18:25:45, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PFP⁹⁷ (xxx)⁹⁸

I akuzuari flet me një PFP dhe e pyet sa para kanë me vete personat në Kroaci. Ai e pyet atë sa persona janë. Ajo i përgjigjet se janë 6 persona. I akuzuari deklaron se njëri grup ka 500 euro dhe grupi tjetër ka 700 euro. I akuzuari i kërkon asaj t'u thotë atyre t'ia japin paratë vozitësit dhe mos të bëjnë probleme.

Në orën 20:00:17, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)⁹⁹

⁹⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 238-239

⁹⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 240-241

⁹⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 242-243

⁹⁷ Person Femër e Panjohur

⁹⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 246-247

⁹⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 248-249

M.C. e pyet të akuzuarin për udhëzime se cilën rrugë të marrin pasi në radhët e migrantëve ka dhe fëmijë. I akuzuari i tregon atij se atje duhet të jetë një burrë, një grua dhe një fëmijë dhe tre të rritur të tjerë. Ai e udhëzoi atë të marrë të 3 të rriturit.

Në orën 20:01:24, i akuzuari (xxx) kontaktoi me G.N. (xxx)¹⁰⁰

I akuzuari e pyet G. N. nëse ajo kishte marrë një thirrje nga C.. Ajo iu përgjigj se kishte folur me C., i cili i kishte thënë asaj se në grup ka fëmijë. I akuzuari e udhëzoi atë se ai do t'i marrë tre të rriturit në mëngjes dhe se burri, gruaja dhe fëmija do të shkojnë pasdite.

Trupi gjykues gjen se "C." është M.C. Kjo bisedë telefonike me G. N. ndodhi rreth një minutë pas bisedës telefonike të të akuzuarit me M.C.. Të dyja bisedat përmendin të njëjtin numër personash të cilët duhet të transportohen.

Në orën 21:59:05, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)¹⁰¹

I akuzuari e pyet M.C. nëse ai është nisur apo jo. Ai iu përgjigj se ata do të niseshin pas 10 minutash për të qenë atje nga ora pesë e tridhjetë e mëngjesit tjetër me vozitësin tjetër.

Në orën 22:53:37, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PFP (xxx)¹⁰²

Bashkëpunëtorja: A dërgove ndonjë kerr për ta atje?

I akuzuari: Jo, nuk dërgova se nuk jam aq i marrë sa të nxjerr jashtë me fëmijë në këtë kohë, ata do të nisen në orën 5 gjatë kohës që bëhen ndërrimet në policinë kufitare ...

¹⁰⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 250-251

¹⁰¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 256-257

¹⁰² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 260-261

25 shkurt 2012

Në orën 04:38:26, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)¹⁰³

I akuzuari: ...a mbërrite?

M.:: Jam atje për 20 minuta dhe ai do të vijë atje në orën pesë....thuaje atyre atje poshtë të mos bëjnë sherr, thirri dhe tregoj se vetëm 3 po shkojnë

Në orën 04:44:27, i akuzuari (xxx) kontaktoi me L.K. (xxx)¹⁰⁴

I akuzuari: ...fol me këta njerëz...ata të rriturit do të ecin në këmbë dhe se burri dhe gruaja do të qëndrojnë atje. Ai do të vijë t'i marrë. Ai burri dhe ajo gruaja nuk do të ecin në këmbë, ata do të shkojnë, më kupton. Ata duhet të kenë 700 euro për t'ia dhënë taksistit, kur të hipin, ata duhet t'i japin atij 700 euro dhe ata duhet të kenë me vete 500 euro. Mos ia jep njeriu deri sa ata të shkojnë në Slloveni. Kur ata të mbërrinë atje, ata duhet të japin ato 500, në rregull?

L.K.:: Në rregull, u krye.

I akuzuari: Pra këta të rriturit do t'i japin 700 taksistit dhe 500 kur ata të jenë në Slloveni.

Në orën 04:48:13, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga M.C. (xxx)¹⁰⁵

M.C.: E gjithë familja do të shkojnë bashkë...ajo thotë se ata janë një familje...

I akuzuari: ...mos i dëgjo budallenjtë, ti merr të rriturit e kupton dhe pastaj vër vetëm bashkëshorten dhe bashkëshortin dhe ata kanë fëmijë tetë vjeç...nëse dëshironi merrni

¹⁰³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 264-267

¹⁰⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 268-271

¹⁰⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 272-275

edhe bashkëshorten dhe fëmijën dhe thojuni atyre të japin edhe 300 të tjera, pastaj ti do të kesh 800 dhe shko ngadalë dhe mos nxito dhe mos u brengos se ata do të të ndihmojnë

M.C.: hajde...e di si është situata...

I akuzuari: askush nuk po shkonte shoku im...për dy muaj e gjysmë, i njëjti mut, mos e thëntë Zoti, i njëjti mut ndodh

I akuzuari: tani ata do të japin 700 euro, ata do t'i japin shokut tim 200 dhe ti do të marrësh 500 dhe familja do të të japë edhe 300 të tjera kështu që ti do të kesh 800 dhe unë do t'i jap shokut tim 500

M.C: Pra deri atje do të jenë edhe dy dele të tjera?

I akuzuari: po, ata janë fëmijë të cilët vinë nga familje të pasura; ata are trembëdhjetë, katërbëdhjetë vjeç, ndoshta pesëmbëdhjetë vjeç

M.C: sa vjeç është i vogli?

I akuzuari: tetë vjeç

M.C: Në rregull atëherë thuaji shokut tënd t'i sjellë dy të tjerët

Në orën 04:55:17, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PMP (xxx)¹⁰⁶

I akuzuari e udhëzon PMP-në të marrë grupin e parë të cilët duhet t'i japin atij 700, përfshirë 200 për veten dhe 500 për bashkëpunëtorin tjetër të tyre dhe pastaj të kthehet

¹⁰⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 280-281

për tre të tjerët.

Në orën 04:57:17, i akuzuari (xxx) kontakton me L.K. (xxx)¹⁰⁷

I akuzuari i kërkon asaj t'i thërrasë ata sepse ata janë në kerr dhe t'u thotë atyre të japin 700 euro dhe gjithashtu t'u thotë atyre se ai do të kthehet për të marrë gruan dhe fëmijën.

Në orën 05:31:17, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PMP (xxx)¹⁰⁸

I akuzuari bisedon me një PMP dhe i thotë atij se ai do të marrë 700 euro dhe se ai do të marrë 200 dhe 500... PMP e pyet të akuzuarin nëse është e saktë se ai do t'i japë atij 500 dhe do të marrë nga i akuzuari 200. I akuzuari i përgjigjet se sapo që çdo gjë të jetë në rregull ai do t'i dërgojë PMP-së 500.

Në orën 05:34:18, i akuzuari (xxx) kontaktoi me L.K. (xxx)¹⁰⁹

I akuzuari: Thirri ata dhe thuaju t'i japin 700 euro atij burrit në kerr, sepse është zbardhur pothuajse.

Në orën 08:07:23, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga M.C. (xxx)¹¹⁰

M.C. e informon të akuzuarin se ai do të mbërrinte në orën 11:00 dhe se migrantët do të transportoheshin me një kerr Mercedes ku ata futeshin të gjithë aty. I akuzuari është i brengosur nëse ata do të mund të futen të gjithë kerr dhe kujton për raste të mëparshme kur ata e kishin "hëngër". Ai e paralajmëron atë të sigurohet që ata të fikin mobilët.

¹⁰⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 268-271

¹⁰⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 290-293

¹⁰⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 294-295

¹¹⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 298-299

Në orën 08:46:17, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga L.K. (xxx)¹¹¹

I akuzuari: ...Jam i mirë në këtë, pavarësisht nëse ka të bëjë me njerëz apo diçka tjetër...unë mund ta bëj këtë punë; të kam thënë tashmë se bashkë me N. kam mbaruar më shumë se një mijë persona.

L.: ...e kam në mendjen time të t'i dërgoj paratë

I akuzuari: Unë do të dërgoj një adresë...ai do të hyjë diku në Itali, ata nuk mund të lëvizin me kerr lart e poshtë lirisht në Itali...ne duhet të shohim nëse ai do t'i cojë ata në Trieste sepse mund të ndodhë që në kufi në Trieste të jetë policia dhe pastaj ai do t'i dërgojë ata në një kufi tjetër...një ditë unë punoj në Medine [Udine?] dhe një ditë në Trieste...

Në orën 08:54:14, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga L.K. (xxx)¹¹²

Luljeta: Sa e ke çmimin tani për fëmijët?

I akuzuari: Gjysmë bilete, për të rriturit është 1400-1500...bëje 500 për ata fëmijët

L.: Do të llogaris për ty 1.4 për person.

I akuzuari: U krye

Në orën 09:35:17, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)¹¹³

I akuzuari: Do t'i them atij të jetë atje për rreth një orë, sa para të dhanë ata dy personat?

M.: 500

¹¹¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 302-307

¹¹² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 308-310

¹¹³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 312-315

I akuzuari: ...Sot do të të dërgoj edhe këtë

M.: Duhet të më japë tani 300 të tjera, e drejtë?

I akuzuari:... nëse nuk do të ketë problem me vozitësin... do të të dërgoj 600 të tjera

Në orën 09:36:52, i akuzuari (xxx) kontakton me një bashkëpunëtor (xxx)¹¹⁴

I akuzuari: Si quhet ajo çika atje?

Bashkëpunëtori: Quhet Starod, rreth 10km afër Bisticës.¹¹⁵

Në orën 10:38:35, i akuzuari (xxx) mori një SMS nga një PMP (xxx)¹¹⁶ në të cilin thuhej:

“Racicë, 2 km para Starodit”¹¹⁷

Në orën 10:46:44, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹¹⁸

I akuzuari i kërkon atij të transportojë disa njerëz nga Ilirska Bistrica në Udine por ai refuzoi.

Në orën 10:57:59 i akuzuari (xxx) u kontaktua nga L.K. (xxx)¹¹⁹

¹¹⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 316-317

¹¹⁵ Starod është në Slloveni, ndodhet në kufirin Kroaci-Slloveni.

¹¹⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 322-323

¹¹⁷ Račice është në Slloveni, Ilirska Bistrica pas pikë-kalimit kufitar me Kroacinë në Starod.

¹¹⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 324-325

¹¹⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 330-333

I akuzuari i tregon L.K. se ata duhet të shkojnë në Udine¹²⁰

Në orën 11:27:14, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga O.K. (xxx)¹²¹

O.K.: A ka mbërritur familja në Trieste akoma?

I akuzuari: ...jo, jo në Udine. Jo në Trieste.

Në orën 13:57:35, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga C. K. (xxx)¹²²

C.K.: Jam vëllai i O, C ...ata i kapën në Itali.

I akuzuari: Ata i kapën në Itali, 1km larg Triestes. Karabinierët i kapën ata gjatë kontrollit. I kapën të gjithë, bashkë me vozitësin.

C.K.: A do t'i kthejnë ata në Slloveni?

I akuzuari: Sllovenia është 15 minuta larg me vozitje nga Italia

C.K.: ... Shpresoj të mos i kthejnë në Turqi.

26 shkurt 2012

Në orën 09:22:28, i akuzuari (xxx) kontaktoi me L.K. (xxx)¹²³

¹²⁰ Itali

¹²¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 341-342

¹²² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 356-357

¹²³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A VII, f. 358-361

I akuzuari: Ata u kapën nga policia në Itali...

L.K.:: është në Udine, Itali?

I akuzuari: Jo, është në Trieste. Ata u kapën pasi kishin kaluar kufirin dhe kishin bërë një kilometër.

Trupi gjykues gjen se Z.G., A.G., M.G., B.G., dhe G.K. u arrestuan më 25 shkurt 2012 Iliriska Bistrica, Slloveni, një qytet ndërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë dhe kufijve Slloveni-Itali. Të gjithë ishin shtetas të Turqisë.¹²⁴

26 shkurt to 10 mars 2012

Gjatë kësaj periudhe përgjimi u vërtetua se i akuzuari u përfshi në kontrabandimin e H.K., shtetas turk, G.K, shtetas i Kosovës dhe H.B, shtetas serb, nga Kroacia përmes Sllovenisë për në Itali.

26 shkurt 2012

Në orën 09:31:28, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga I. (xxx)¹²⁵

Diskutim ndërmjet të akuzuarit dhe 'I.' për dërgimin e vëllait të I.' jashtë shtetit.

27 shkurt 2012

Në orën 19:17:18, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PMP (xxx)¹²⁶

¹²⁴ Raport i datës 7 mars 2012 i nënshkruar nga M.J.

¹²⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 362-366

¹²⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 395-396

PMP: Familja është shumë probleme. Nga Sllovenia në Zagreb, Zagreb në Stamboll.

I akuzuari: Ata u kapën. Çfarë mund të bëjmë?

PMP: Janë shumë shpenzime. A ka ndonjë rrugë të sigurt për nesër në mëngjes?

I akuzuari: po, por sa njerëz?

PMP: Dy vetë.

I akuzuari: ...ku janë?

PMP: ...Zagreb

6 mars 2012

Në orën 14:06:24, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga O.K. (xxx)¹²⁷

'H': është caktuar për 1 pasagjer?

I akuzuari: fola me vozitësin, ai më tha se udhëton nesër e sigurt ...

Telefoni numër xxx është përdorur nga L.K. dhe O.K.. . Me këtë rast personi i thirrur përmendet me emrin 'H'.

Në orën 22:37:41, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga L.K. (xxx)¹²⁸

I akuzuari: ...më thirri O. dhe më tregoi për atë fjalon atje që keni në Rjekë...

¹²⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 407-408

¹²⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. Vii, f. 411-414

L.: çfarë ore nesër?

I akuzuari: ose në mëngjes ose në mbrëmje, do ta marr...ec i sigurt më dëgjo sepse kam edhe njerëzit e mi rrugës ...

L.: Në rregull u krye

8 mars 2012

Në orën 21:11:29, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹²⁹

I akuzuari: Ku je tani?

PMP: në varkë

9 mars 2012

Në orën 21:43:24, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹³⁰

I akuzuari: Ku jeni tani?

PMP: Po kërcejmë mbi gardh/pengesë.

I akuzuari: Çfarë lloj gardhi/pengese janë ato?

PMP: ...të mëdha prej betoni

¹²⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 425-426

¹³⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 444-447

I akuzuari: ... është me rrjetë/tela?

PMP: po

I akuzuari: a sheh shumë drita atje?

PMP: po

I akuzuari: mos kërce mbi të njeri sepse ai është kopsht zoologjik ...shko poshtë tij anash deri në fund të tij...a e keni gardhin me tela?

PMP: po

I akuzuari: ...mos kërce mbi të dhe shko në anën tjetër sepse ka qen ... ec në të majtë anash tij.

Qartazi i akuzuari po i jep orientime një migranti i cili dyshohet se po kalon kufirin ndërmjet Sllovenisë dhe Italisë në mënyrë të paligjshme.

Në orën 22:15:54, i akuzuari (xxx) thirri një PMP (xxx)¹³¹

I akuzuari: “Ngjitur lart në kodër, kapërce asfaltin dhe pastaj do të shohësh një fushë tenisi, pas asaj ka 5-6 traka hekurudhore që duhet t’i kaloni dhe pastaj ka vetëm një hekurudhë tjetër që duhet ta kapërceni për të kaluar në anën tjetër”.

I akuzuari vazhdon t’i japë orientime një migranti i cili dyshohet se po kalon kufirin ndërmjet Sllovenisë dhe Italisë në mënyrë të paligjshme.

¹³¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 439-441

Në orën 22:21:56 i akuzuari (xxx) thirri një PMP (xxx)¹³²

I akuzuari: A janë trenat larg në anën e majtë?

PMP: ...ata are rreth 100 metra larg

I akuzuari: Sa kohë?

PMP: 100 metra 200

I akuzuari: A po zbret kodrën tani apo si?

PMP: A duhet me u ngjit në këtë kodër përmes kësaj lugine?

I akuzuari: A i sheh ata trenat?...Ti je atje poshtë për t'i kaluar ata ...

PMP: A të shkoj pranë trenave?

I akuzuari: Zbrit pak poshtë nga lugina dhe pastaj ngjitu lart në kodër përpara teje dhe ngjitu lart. A i sheh dritat atje lart në rrugë? ...A mund të shkosh tek ato drita dhe kur shkon lart tek ato drita a i sheh dritat e fundit para teje? Atje është një vend ku duhet të shkosh dhe atje ka asfalt që duhet ta kalosh dhe pastaj kthehu për tek hekurudha përsëri dhe vazhdo që andej. Aty ka pisha. Vazhdo shko drejt.

10 mars 2012

Në orën 08:47:21, i akuzuari (xxx) mori një SMS (xxx)¹³³ në të cilin thuhej:

¹³² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 435-438

¹³³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 465-466

“Na kapën në kufirin italian. Nuk flas dot. Mos më thirr.”

Në orën 09:06:34, i akuzuari (xxx) mori një SMS nga the K. brothers (xxx)¹³⁴ në të cilin thuhej:

“A i kanë kapur në Itali apo ku? Më thuaj, duhet ta dimë që t’i tregojmë familjes së tij se ku e kanë kapur”

G.K., shtetas i Kosovës, Sh.B., shtetas i Kosovës, H.B., shtetas serb, T.H, shtetas i Kosovës, dhe H.K u arrestuan më 10 mars 2012 në Ilirska Bistrica, Slloveni, një qytezë pranë kufirit Kroaci-Slloveni. Të gjithë ishin shtetas të Turqisë.¹³⁵

15 mars 2012

Në orën 10:28:04, i akuzuari (xxx) mori një SMS nga një PMP (xxx)¹³⁶ në të cilin thuhej:

“Fol me T dhe T. do t’i sjellë ata persona nga Negrovs, ata do t’i lirojnë sot, do t’i sjellin me avion, dhe Shpejtimi nesër...”

Në orën 11:26:28, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP në qendrën e ndalimit në Slloveni (xxx)¹³⁷

I akuzuari: Kur do të të nisin për këtu?

PMP: Unë dhe G. do të ikim që këtej sot në orën tre dhe Shpejtimi do të shkojë nesër.

Në orën 13:36:28, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një bashkëpunëtor (xxx)¹³⁸

¹³⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 459-460

¹³⁵ Raport i datës 12 mars 2012 i nënshkruar nga M.J.

¹³⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 31-32

¹³⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 35-36

¹³⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 37-38

PMP i tregon të akuzuarit se “T. dhe ai i riu u nisën sot, ata hipën në aeroplan në orën 3” dhe e këshillon të shkojë t’i marrë në orën 4:30.

16 mars 2012

Në orën 22:54:43, i akuzuari (xxx) thërret Sh.B. (xxx)¹³⁹

Sh.B.: Sapo dolëm, u ulëm tani.

I akuzuari: Kur të të pyesin, ti duhet të thash se ke qenë në Kroaci dhe thuaj se duhet të punosh, kështu e ashtu, a më dëgjon?

Argumenti i Akuzës ishte se Sh.B. dhe T.H. nga Kosova dhe H.B., shtetas serb por që jeton në Mal të Zi “malazezi” ishin transportuesit të cilët punonin me A.B.. G.K, shtetas i Kosovës, dhe H.K, shtetas turk, ishin dy personat të cilët do të kontrabandoheshin në BE.

Mbikëqyrja fotografike nga policia e EULEX-it e tregon të akuzuarin duke marrë T.H. dhe G.K. nga aeroporti i Prishtinës.

24 shkurt deri më 16 mars 2012

Gjatë kësaj periudhe përgjimi u vërtetua se i akuzuari u përfshi në kontrabandimin e A.B., shtetas i Kosovës, M.H, shtetas i Kosovës, R.R, shtetas i Kosovës, R.J., shtetas i Kosovës dhe A.K, shtetas i Kosovës, nga Kosova përmes Malit të Zi dhe Kroacisë për në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar.

24 shkurt 2012

¹³⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 113-114

Në orën 18:05:10, i akuzuari (xxx) u thirr nga "V." (xxx)¹⁴⁰

V. i prezantohet të akuzuarit dhe i thotë se ai ka "katër automjete". I akuzuari e pyet V. nëse ata janë gati sepse ai do të niset nesër mbrëma për të shkuar atje.

Trupi gjykues gjen se "automjetet" ishin referencë e koduar për një grup prej 4 migrantësh të cilët do të kontrabandoheshin.

14 mars 2012

Në orën 17:12:39 i akuzuari (xxx) u thirr nga H.B. duke përdorur telefonin e G.N. (xxx)¹⁴¹

H.B.: Po kalojmë kohë të vështirë duke ndenjur këtu, katastrofë ... thirri ata turqit sepse ky këtu është çmendur, ajo është nervoze, e kupton?

I akuzuari: I thirra ata, se N nuk po përgjigjet në telefon. I tregova O. se N. [më] dërgoi tek ai.

H.B.:: ...ajo tha se nëse njëri prej tyre nuk i dërgon paratë, ajo tha se unë nuk do t'i marr kurrë njerëzit e tyre. E kupton, prish punën tënde

I akuzuari: Nuk kam asgjë me atë punë, nuk i kam borxh asaj asnjë cent.

H.B.:: Ajo nuk po thotë se ti i ke borxh asaj...por ajo po thotë se ata erdhën të gjithë përmes teje, a kupton, ajo po thotë unë i prita ata për shkak të tij.

Pastaj i akuzuari i jep atij numrin e "C.", numrin në Mal të Zi, xxx

¹⁴⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 240-245

¹⁴¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 1-4

Argumenti i Akuzës ishte se “C” punonte si udhërrëfyes/transportues për grupin e organizuar kriminal, duke i udhëhequr migrantët përmes kufirit Slloveni - Itali në pika kalimi të paligjshme.

Në orën 17:15:03 i akuzuari (xxx) u kontaktua nga H.B. duke përdorur telefonin e G.N. (xxx)¹⁴²

I akuzuari: Thuaji atij sllovenit kur të vijë C., kur të të dërgojë ty në anën tjetër, ai do të të marrë vetëm ty, ai do të të fusë ty në kerr ...

Në orën 17:25:59, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga “C.” (xxx)¹⁴³

C: Unë dola për të marrë ca ujë për nesër, ne po bëhemi gati por ai malazezi u zhduk, ai nuk erdhi më për të marrë paratë nga këta këtu

I akuzuari: ...merr 300 prej tij, a mjaftojnë

C: Të marr 300 nga ky këtu, thuaji atij të marrë 1000 sepse ai duhet të bëjë menjëherë 300 në Kuna, unë do të kem rreth 100 në xhep.

I akuzuari: ... merr 300 prej tij, ata bëjnë 1500, jepi atij 7-800, dhe ti do të kesh 2-300 për veten...

C: Ok merr këtë këtu dhe fol më atë M..

I akuzuari: Do t'i them M. t'i japin atij vozitësi 300 secili, t'i them atij malazezit të sigurojë rreth 700.

C.: Ai mund të sigurojë edhe 800, për mua do të ishte në rregull nëse kam 200 euro në xhep.

¹⁴² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 5-8

¹⁴³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 9-12

Në orën 17:28:57, i akuzuari (xxx) kontaktoi me "C" (xxx)¹⁴⁴

I akuzuari: Ku je?

C: Jam rrugës...

I akuzuari: Thashë të shkoj të marr çfarë duhet të marrësh

Në orën 17:30:11 i akuzuari (xxx) kontaktoi me "C" (xxx)¹⁴⁵

I akuzuari e informon atë se ai foli me malazezin dhe të bëjë marrëveshje me të.

Në orën 18:21:12, i akuzuari (xxx) kontaktoi me "C." (xxx)¹⁴⁶

Bashkëpunëtori: Erdhi ky malazezi sepse ai rezervoi kerret atje në një rent a car, ai po kërkon paratë tani

I akuzuari: Ma kalo M. në telefon...(i kalon telefonin) dëgjo M. rregulloje punën t'i jepni këtij 300 euro secili...ju të pestë do t'i jepni atij 300 secili.

Në orën 19:05:26, i akuzuari (xxx) thirri "C" (xxx)¹⁴⁷

Bashkëpunëtori: malazezi mori 1000 euro...ai tipi nga Malisheva, jo ai bir polici por ai tjetri tha unë nuk jap para deri sa Gorizi, i thashë merr 300 dhe kthehu në shtëpi...

¹⁴⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 13-14

¹⁴⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 15-16

¹⁴⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 17-20

¹⁴⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 21-22

Në orën 19:13:14 i akuzuari (xxx) kontaktoi me "C." (xxx)¹⁴⁸

C.:...a ke folur me atë I. që mori paratë?

I akuzuari: po

C.: A kemi vendosur për 2500 a 2600 apo ata po na gënjejnë?

I akuzuari: Jo, e pyeta I., ai tha 2500

C.: Ok...do të dëgjohemi bashkë nesër, kur unë të hyj atje

Në orën 19:15:48, i akuzuari (xxx) kontakton me një PMP (xxx)¹⁴⁹

I akuzuari e pyet PMP-në nëse "ata t'i lanë ty ato gjërat". PMP konfirmon "ato janë këtu". Pastaj i akuzuari thotë se ata do të arrijnë atje nesër dhe se ata do të mbarojnë gjërat.

15 mars 2012

Në orën 07:27:33 i akuzuari (xxx) kontaktoi me "C." (xxx)¹⁵⁰

C.": E kam kaluar këtë rrugë më lart, jemi larg rrugës rreth 20-30m, mirë deri këtu, I do të vë në dijeni kur të mbërrij në fund

Në orën 11:24:14, i akuzuari (xxx) kontakton me "C." (xxx)¹⁵¹

¹⁴⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 23-26

¹⁴⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 27-28

¹⁵⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 29-30

¹⁵¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 33-34

C.”: ... malazezi tha se ne nuk do të nisemi deri në mbrëmje

I akuzuari: ...Fola me të dhe ai më tha se kur unë shkova të marr kerret pashë se atje ka shumë kontrolle, prandaj ti të nisesh në mbrëmje.

Në orën 19:23:29, i akuzuari (xxx) kontaktoi me “C.” (xxx)¹⁵²

I akuzuari: Ku jeni tani?

C: pothuajse mbërritëm në Dubrovnik, por nuk kemi para sepse ai nuk këmbëu, gjëja më e keqe që mund të ndodhë është se ne duhet të kthehemi e të qëndrojmë në pyll përsëri

I akuzuari: ...a është ai malazezi me ju tani?

C: po

Në orën 20:46:35, i akuzuari (xxx) kontaktoi me “C” (xxx)¹⁵³

C e informon të akuzuarin se ata janë “në anije”

I akuzuari i tregon atij se ai e informoi Remziun për vështirësitë me paratë por e udhëzon C mos t’i tregojë I. [H.]. I akuzuari i tregon atij se T. mbërriti dhe se Sh. do të vijë nesër.

Argumenti i Akuzës ishte se i akuzuari po transportonte një grup migrantësh, disa prej bashkëpunëtorëve të tij ishin kapur ndërsa po transportonin një grup më herët dhe po kthehen në Kosovë pasi ishin mbajtur në një kamp në Slloveni për migrantë të paligjshëm.

Në orën 23:00:25, i akuzuari (xxx) kontaktoi me “C.” (xxx)¹⁵⁴

¹⁵² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 45-49

¹⁵³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 52-53

¹⁵⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 54-55

C.” i thotë të akuzuarit t’i telefonojë personit nga Mali i Zi sepse “ata kanë vetëm dy vende të lira për të fjetur”

Në orën 23:02:18, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga një PMP (xxx)¹⁵⁵

I akuzuari e udhëzon bashkëpunëtorin e tij “dërgoji ata atje”

Në orën 23:05:26, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP në (xxx)¹⁵⁶

Bashkëpunëtori e pyet të akuzuarin “ku jeton taksistit?” dhe i akuzuari i përgjigjet “Bjelo Luka” para se bashkëpunëtori ta mbyllë telefonin duke i thënë “tung tani se d të na kapë policia”

Në orën 23:08:24 i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP në (xxx)¹⁵⁷

Bashkëpunëtori i tregon të akuzuarit se ata kanë ngecur në kerr. I akuzuari e informon atë se ai e kishte thirrur tashmë transportin tjetër dhe i tha atij “lëviz më shpejt se po presin njerëzit jashtë”

Në orën 23:17:21, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP në (xxx)¹⁵⁸

Bashkëpunëtori konfirmon se ata hipën në kerr dhe gjatë bisedës telefonike përmend një kerr të dytë.

Argumenti i Akuzës ishte se migrantët ndërruan automjete në një pikë të caktuar dhe po udhëtojnë në dy vetura të ndryshme.

¹⁵⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 56-57

¹⁵⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 58-59

¹⁵⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 60-61

¹⁵⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 62-63

Në orën 23:25:07, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁵⁹

I akuzuari thotë “alo (si në origjinal) M.” por informohet “nuk është ai, ai është në kerrin tjetër”. I akuzuari e pyet PMP-në nëse ata mbërritën në banesë por i thuhet se ata po presin ende në kerr.

Në orën 23:40:16, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga një PMP (xxx)¹⁶⁰

I akuzuari bisedon me një PMP dhe e pyet nëse ata gjetën vend ku të rrinë. PMP i përgjigjet “jo, vetëm ai gjeti një vend për veten”.

16 mars 2012

Në orën 09:42:06, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga një PMP (xxx)¹⁶¹

I akuzuari e pyet PMP-në nëse ata kanë zbritur nga anija.

Në orën 09:43:43, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁶²

PMP i tregon i akuzuari “po mbërritëm, jemi në Split...”

Në orën 15:51:08, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁶³

PMP i tregon të akuzuarit se ata janë afërsisht 170 – 200 km larg Rjekës.

¹⁵⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 68-69

¹⁶⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 70-71

¹⁶¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 72-73

¹⁶² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A.VIII, p. 75

¹⁶³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, p. 101

Në orën 15:56:09, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁶⁴

I akuzuari: edhe 150 km të tjera dhe ata do të mbërrijnë atje, mbaje telefonin pranë që kur ai të thërrasë dhe të tregon vendin kur të takoheni, shko dhe takoje.

PMP: po, kështu është marrëveshja sepse folam me të dhe ai tha rreth gjashtës ose gjashtë e gjysmës.

Në orën 16:46:10, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PMP (xxx)¹⁶⁵

I akuzuari i tregon PMP-së se ai i tha malazetit se ai do t'i marrë paratë kur ata të mbërrijnë në Slloveni dhe PMP ra dakord me 100 euro për secilin.

Në orën 18:22:06, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁶⁶

PMP deklaroi se ai është rrugës për në stacion por se ai nuk i kishte takuar ata ende.

Në orën 18:49:52, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁶⁷

PMP konfirmon se ai i ka takuar ata dhe thotë ata po lëvizin me automjet.

Në orën 19:18:06, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁶⁸

PMP i thotë të akuzuarit mos ta thërrasë sepse ata janë në rrugë.

¹⁶⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 103-104

¹⁶⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 105-106

¹⁶⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 107-108

¹⁶⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 109-110

¹⁶⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 111-112

17 mars 2012

Në orën 02:26:11, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PMP (xxx)¹⁶⁹

PMP po i pret “ata” në Ilirska Bistrica, Slloveni. Këta persona po kalojnë kufirin në këmbë. I akuzuari e udhëzon PMP-në t’i takojë ata në vendin e rënë dakord në orën 5.

Në orën 04:08:39, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga PMP (xxx)¹⁷⁰

PMP e pyet të akuzuarin nëse ata kanë thirrur. I akuzuari i thotë atij të presë dhe thotë se atij mund t’i duhet të shkojë e t’i marrë ata.

Në orën 05:00:38, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga PMP (xxx)¹⁷¹

PMP e pyet të akuzuarin nëse ata kanë thirrur. I akuzuari i thotë se ata nuk kanë thirrur dhe se ata mund të kenë marrë një rrugë më të gjatë.

Në orën 05:06:20, i akuzuari (xxx) kontaktoi me PMP-në (xxx)¹⁷²

PMP e pyet të akuzuarin nëse ata kishin thirrur sepse tani kishte kaluar ora 5 dhe policia kufitare kishte filluar shërbimin dhe nëse ata janë 15-20 minuta të tjera ai nuk mund të shkojë t’i marrë.

Në orën 06:04:59, i akuzuari (xxx) kontaktoi me PMP-në (xxx)¹⁷³

¹⁶⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 115-116

¹⁷⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, p. 118

¹⁷¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A.VIII, p. 120

¹⁷² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 121-122

¹⁷³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 128-129

I akuzuari i tregon PMP-së se ata nuk kanë thirrur. PMP i thotë se ata do të duhet të presin deri sa të errësohet.

Në orën 08:42:15, i akuzuari (xxx) kontaktoi me "A. Sh." (xxx)¹⁷⁴

I akuzuari thotë se ata nuk përgjigjen kur ai i thërret dhe se brengoset se ata mund të jenë kapur sepse "H" është i pafat.

Në orën 10:13:35, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁷⁵

PMP:...sapo kalova kufirin kroat

I akuzuari: Duket se ata kanë mbaruar ... atje në [territorin] slloven ... pidhi nonës ma ha mendja se ishe bastisje...ti e pe atë njeri herën e fundit

PMP: E di, i njëjti person ters

Argumenti i Akuzës ishte se migrantët po udhëtonin të ndarë.

Në orën 10:20:40, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁷⁶

I akuzuari e informon PMP-në se shoku i tij nga Spliti do të vijë ta marrë dhe do t'i japë atij 2500 euro. I akuzuari i tregon PMP-së se më vonë ata do të bëjnë një marrëveshje.

Në orën 15:19:26, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁷⁷

¹⁷⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 131-132

¹⁷⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 135-138

¹⁷⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 139-140

¹⁷⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, p. 142

I akuzuari i tregon PMP-së se ata mund të jenë kapur pasi hynë në Slloveni sepse atje nuk ka pasur reagim prej tyre.

Në orën 15:23:40, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga një PMP (xxx)¹⁷⁸

PMP e pyet për vëllain e tij i cili ishte në grupin e fundit. I akuzuari deklaron se ata nuk janë përgjigjur dhe personi që udhëtonte me ta nuk është përgjigjur dhe se ai është i sigurt se ata janë kapur. I akuzuari thotë ai do të përpiqet dhe do të vendosë kontakt me ta dhe të përcaktojë nëse ata do të dërgohen në një kamp në Slloveni ose Kroaci.

Në orën 18:15:59, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga një PMP (xxx)¹⁷⁹

PMP prezantohet si 'P.' dhe e pyet nëse ka ndonjë të re, pasi telefoni i vëllait të dhe telefoni shokut të vëllait të tij janë të fikur. I akuzuari thotë se me ta është axha i tij dhe se asnjëri prej tyre nuk u është përgjigjur thirrjeve të tij. PMP e pyet nëse ata i kishin kapur në Slloveni.

Në orën 18:47:00, i akuzuari (xxx) i dërgoi një SMS "A. Sh" (xxx)¹⁸⁰ në të cilin thuhet:

"Shoku im, doku u kap, tregoji atij"

Në orën 20:07:01, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁸¹

I akuzuari e pyet PMP-në nëse ndonjë njeri nga Kosova e kishin sjellë sot. PMP thotë jo. I akuzuari i tregon PMP-së se nëse vjen një person i quajtur "I", ta informojë atë se po e kërkon 'H' dhe ta thërrasë menjëherë.

¹⁷⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 143-144

¹⁷⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 148

¹⁸⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A.VIII, f. 151-152

¹⁸¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 142

Në orën 21:31:15, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga M.H. (xxx)¹⁸²

M.H. e pyet të akuzuarin nëse ai kishte folur me Isufin sepse ata i kishin kapur. I akuzuari i thotë atij të mos i tregojë njeriu, duke thënë ata do të mbaheshin 2 ditë dhe pastaj do të ktheheshin.

18 mars 2012

Në orën 08:01:39, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga një PMP (xxx)¹⁸³

Të akuzuarit i thuhet se 5-6 persona ishin sjellë nga Kosova natën e kaluar. Ai kërkon të flasë me 'I.'. I. i tregon të akuzuarit se ai dhe H. dhe të tjerët ishin "kapur menjëherë sapo kishin kaluar urën".

Në orën 08:26:25, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁸⁴

I akuzuari i tregon PMP-së se "sapo mësova se ata janë në një kamp në Kroaci dhe ju mund të bisedoni me ta në numrin xxx.."

Në orën 08:29:28, i akuzuari (xxx) kontaktoi me vëllain e migrantit A.K. (xxx)¹⁸⁵

I akuzuari i tregon PMP-së "ata janë kapur, ata janë në një kamp në Kroaci. A më thirre për A..?" PMP i përgjigjet "Jam vëllai i A.2. nga Damaneku" dhe thotë ata do t'i kthejnë këtë javë.

Në orën 12:17:04, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁸⁶

¹⁸² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 484-488

¹⁸³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 161-162

¹⁸⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 161-162

¹⁸⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 166

¹⁸⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 173-174

I akuzuari i thotë PMP-së t'ua kthejë gjërat atyre pasi ata ishin kapur.

19 mars 2012

Në orën 11:00:45, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁸⁷

I akuzuari flet me M. dhe I. dhe gjatë kësaj bisede përmend A.1... Ai u thotë atyre se kur të kthehen në Kosovë ata duhet të thonë se shkuan në Kroaci për të punuar. Ai thotë se A.1.. ka thënë se ai do të “tregojë çdo gjë që ka ndodhur”. I akuzuari i kërkoi M. të flasë me A.1...

Në orën 11:19:05, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁸⁸

I akuzuari e pyet PMP-në nëse ai është vëllai i A.1.. PMP përgjigjet po. I akuzuari i thotë atij të flasë me A.1.. dhe t'i thotë atij mos të flasë pasi ai kishte kërcënuar se do të “tregonte çdo gjë” kur ta kthejnë në Kosovë.

Në orën 11:20:22, i akuzuari (xxx) kontaktoi me PMP (xxx)¹⁸⁹

I akuzuari i kërkon PMP-së të bisedojë me vëllain e tij sot. PMP e pyet të akuzuarin “Çfarë të bëj lidhur me çështjen e pagesës”. I akuzuari i përgjigjet duke thënë “shko dhe merr paratë në vendin ku i ke lënë.”

Në orën 11:25:58, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁹⁰

¹⁸⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 188

¹⁸⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 190

¹⁸⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 192

¹⁹⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 194

I akuzuari flet me I dhe i thotë “Fola me vëllain e A.1. dhe ai më tha mos u brengos se ai nuk guxon të thotë asnjë fjalë.”

20 mars 2012

Në orën 15:56:13, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga “P.” (xxx)¹⁹¹

P. i tregon të akuzuarit se ai po heton për A.1.. I akuzuari i tregon atij se A.1.. do të kthehet në Kosovë nesër. Bëhet një diskutim për paratë. I akuzuari i thotë P. se ata i kërkuan A.1. 500 euro për ‘shpenzimet’. P. është i nehur për humbjen e parave dhe thotë se i akuzuari duhej t’i kishte treguar atij se persona të tjerë ishin kapur nga policia gjatë rrugës. I akuzuari këmbëngul “ishte një kontroll i madh, pikë kontrolli e madhe”, jo faji i tij. I akuzuari dhe P. diskutojnë për dërgimin e A.1 jashtë shtetit. I akuzuari kërkon pagesë prej 1000 eurosh. Pastaj i akuzuari thotë se A.1 duhet të paguajë 500 euro kur të mbërrijë në anën tjetër të kufirit. PMP i thotë të akuzuarit “ti nuk ke detyrim tjetër por vetëm ta dërgosh atë në tokën kroate”.

24 mars 2012

Në orën 13:47:44, i akuzuari (xxx) kontaktoi me migrantin A.B. (xxx)¹⁹²

A.1. flet me të akuzuarin dhe ankohet për telashin në të cilin ai thotë se i futi i akuzuari. Ai thotë “Jam në borxh deri në fyt vetëm për të mbërritur atje.” Ai ankohet se i akuzuari nuk u tregoi atyre ai kishte njerëz tashmë në burg.

I akuzuari i thotë A.1. “..nuk jam vetëm unë që po e bëj këtë punë por është edhe djali i axhës tim që po e bën këtë, prandaj kur i futën ata në burg...i pyetën me kë u nisët dhe ata vetëm gënjen duke u dhënë emrin tim...për më shumë se një vit unë nuk pata njeri tjetër përveç teje.” I akuzuari i tregon A.1. se ai ia dërgoi të 700 eurot “atij personi” me

¹⁹¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 199-207

¹⁹² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 290-297

Western Union. I akuzuari i thotë A.1. "Pra, kur të kem turin tjetër, nëse dëshiron mund të të thërras dhe do të përpiqem të të ndihmoj njeri, mund të të dërgoj atje...Petriti vëllai yt më thirri nga Italia dhe më tha se mund të vijë të të marrë një slloven."

I.H.,, shtetas i Kosovës, A.B.,, shtetas i Kosovës, M.H, shtetas i Kosovës, H.B, shtetas serb, R.R.,, shtetas serb, R.J, shtetas i Kosovës, dhe A.K, shtetas i Kosovës, u arrestuan më 16 mars 2012 në fshatin Sapjane, Kroaci, afër Ilirska Bistrica, Slloveni, pikë-kalimi kufitar ndërmjet Kroacisë – Sllovenisë për migrim të paligjshëm.¹⁹³

17 mars deri më 29 mars 2012

Gjatë kësaj periudhe përgjimi u vërtetua se i akuzuari u përfshi në kontrabandimin e B. (mbiemri i panjohur), dhe dy migrantëve të tjerë nga Kosova përmes Malit të Zi dhe Kroacisë dhe në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar.

17 mars 2012

Në orën 18:00:18 i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PMP (xxx)¹⁹⁴

PMP e pyet të akuzuarin sa do të kushtonte të dërgoje një njeri jashtë shtetit. I akuzuari i tregon atij se çmimi është "2800 euro deri sa ata të mbërrijnë në vend". PMP përgjigjet se ai i tha atij 3000 euro, dhe i akuzuari përgjigjet se ai mund t'i mbajë 200 të tepërtat për veten.

Në orën 21:33:56, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga një PMP (xxx)¹⁹⁵

¹⁹³ Raport i datës 19 mars 2012 i nënshkruar nga Milanka Jug

¹⁹⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të Ardianit VII, f. 480

¹⁹⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 157-158

PMP e pyet të akuzuarin “kur do të nisen ata që janë këtu?” I akuzuari i thotë atij se ata do t’i dërgojë axha i tij.

Argumenti i Akuzës ishte se ‘axha’ është T.H...

18 mars 2012

Në orën 03:28:28, i akuzuari (xxx) mori një SMS nga një person (xxx),¹⁹⁶ në të cilin thuhej:

“...Më dërguan me autobus nga Gostivari në Bujanovac...”

Në orën 16:18, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁹⁷

I akuzuari e pyet PMP-në nëse ai mund të shkonte në Mal të Zi, ai e refuzon por pranon “t’ia dërgojë” një personi në aeroportin e Dubrovnikut.

Në orën 16:20:23, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)¹⁹⁸

I akuzuari i kërkon PMP-së t’ia dërgojë “atë” një shoku në aeroportin e Dubrovnikut dhe thotë “ti do të marrësh nga ai 2500 euro dhe pastaj do të bëjmë marrëveshje”.

21 mars 2012

Në orën 11:31:56, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)¹⁹⁹

¹⁹⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 160-161

¹⁹⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 175-176

¹⁹⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 177-178

¹⁹⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 208-209

I akuzuari i tregon M.C. se ai po “mblidhet” dhe se ai do ta informojë PMP-në sapo të jetë gati.

Në orën 17:16:03, i akuzuari (xxx) kontaktoi me “B.” (xxx)²⁰⁰

I akuzuari: A jeni gati për nesër?

B.:: Mendon vërtet për nesër, ku je?

I akuzuari: Jam në Komoran duke biseduar me të dy djemtë

Në orën 18:23:27, i akuzuari (xxx) kontaktoi me “N.” (xxx)²⁰¹

I akuzuari: nesër në mëngjes, atje [Mal të Zi] do të vinë disa miq ... ata nisen rreth orës 04:00 kështu që rreth orës 11:00 do të jenë atje

Në orën 18:36:25, i akuzuari (xxx) kontaktoi me I.H. në kampin e paraburgimit në Kroaci (xxx)²⁰²

I akuzuari: Unë do të dërgoj Q. e M. dhe tre të tjerë sot me B...B. e Komoranës

22 mars 2012

Në orën 18:44:50, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)²⁰³

I akuzuari: të dielën kam dy shokë për të dërguar atje, ku i dërgon zakonisht të gjithë.

²⁰⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 210-211

²⁰¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 212-213

²⁰² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 214-215

²⁰³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 216-219

PMP: Ok, çfarë ore dhe si?

I akuzuari: ...në mëngjes në 8 ose 9...ti e di vendin që merr?

PMP: po

R.: kur të mbërrimë atje, a do të vijmë nga automjeti që erdhëm drejt automjetit tënd?

A është kjo lidhja?

...

I akuzuari: po, pasi të mbërrish eja tek automjeti IM....unë do të të thërras kur të kalohet kufiri i Sllovenisë.

Gjatë asaj bisede, R. përmend "A". Trupi gjykues gjen se me këtë bëhej fjalë për të akuzuarin.

23 mars 2012

Në orën 08:45:50, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)²⁰⁴

I akuzuari e pyet PMP-në nëse ata mund të qëndrojnë në banesën e tij në Budva. Ai pajtohet.

Në orën 10:38:44, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)²⁰⁵

I akuzuari: shko tek stacioni i autobusit sepse ata po të presin

Në orën 19:09:52, i akuzuari (xxx) i dërgoi një SMS migrantit "Sh. A." (xxx)²⁰⁶ në të cilin thuhet:

²⁰⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 252-253

²⁰⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 254-255

²⁰⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 268-269

“Nuk do të duhet të qëndrosh gjatë. Do të vish të dielën, mos u brengos”

Në orën 19:44:42, i akuzuari (xxx) kontaktoi me në bashkëpunëtor, “KH.” (xxx)²⁰⁷

I akuzuari i tregon atij se ata do të paguajnë 300 euro secili. PMP i kërkon 400 euro për secilin dhe i thotë se ai do të duhet të sigurojë një automjet më të madh. I akuzuari pajtohet se ata do të paguajnë 300 euro secili dhe kur të mbërrijnë në Dubrovnik, ata do t'i japin atij edhe 100 secili. Gjatë bisedës i akuzuari përmend se disa njerëz ishin “kapur.

24 mars 2012

Në orën 12:48:40, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PFP (xxx)²⁰⁸

PFP e informon të akuzuarin se Grozdana është atje dhe se ajo dhe motra e saj ia dërguan paratë H.. Ajo i kishte dërguar atij 500 euro, dhe motra e saj i dërgoi atij 300 euro.

27 mars 2012

Në orën 18:46:01, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga një PMP (xxx)²⁰⁹

I akuzuari i tregon PMP-së se ata mbërritën në Slloveni, por mund të jenë kapur atje

Në orën 18:47:34, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga PFP-ja (xxx)²¹⁰

²⁰⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 272-273

²⁰⁸ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 280-281

²⁰⁹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 300-301

²¹⁰ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 302-303

PPF-ja i tregon të akuzuarit se një person i tretë “shkoi atje” me 500 eurot dhe 300 eurot që ata ia kishin dhënë atij por se ai i kishte mashtruar ata. Ajo thotë “në rast se M. e merr vesh” do të ishte më mirë për të të zhdukej.

Argumenti i Akuzës ishte se këtu bëhej fjalë për Z.M., anëtar kryesor i grupit të organizuar kriminal të A.B. në Kroaci.

28 mars 2012

Në orën 19:42:10, i akuzuari (xxx) kontaktohet nga “A.” (xxx)²¹¹

A. i prezantohet të akuzuarit si vëllai i B.. I akuzuari i tregon atij se B. u kap në Slloveni para se të hynte në Itali dhe se ai do të kthehej në Kosovë.

Prova të tjera të përgjimit në të cilat mbështetet akuza lidhur me Akuzën 2

18 mars 2012

Në orën 13:18:33, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga një PMP (xxx)²¹²

PMP i tregon të akuzuarit se ai e mori numrin nga “dikush që ti e dërgove në Zvicër.”

7 mars 2012

Në orën 15:17:47, i akuzuari (xxx) kontaktoi me an bashkëpunëtori (xxx)²¹³

²¹¹ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VIII, f. 304-305

²¹² PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 489-490

²¹³ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 421-424

I akuzuari: ...ai tha se kur ata shkuan në kufi me Zvicrën ...ata u bënë atyre dokumentet gati...

Bashkëpunëtori: ...personit të gjatë, ai ia dha atij në dorë kur ai i dha atij paratë dhe këtij tjetrit ai harroi fare t'ia jepte atij

I akuzuari: ...të më thërrasë T. dhe do t'i them këtu është numri i atij që i voziti ata dhe merr vesh prej tij çfarë keni bërë atje lart, ata kanë biseduar me të atje

22 shkurt 2012

Në orën 10:14:33, i akuzuari (xxx) u kontaktua nga L.K. (xxx)²¹⁴

L.: Sa orë ecën ata me ty?

I akuzuari: Unë punoj në mbrëmje dhe gjatë ditës, për shembull i marr ata në 4 të mëngjesit pastaj ata duhet të ecin rreth 1 orë e gjysmë ndërsa po t'i marr në mbrëmje ata duhet të ecin rreth 2 ose 3 orë...

L.: herën e fundit atyre iu desh të ecnin 5 orë

I akuzuari: ...ata nuk mund të ecin për atje 5 orë për shkak të vendit, për 5 orë ata mund të shkojnë në Lubjanë duke ecur

L.: vërtet 5 orë ata kanë ecur, pastaj ata bënë një thirrje, bile po qanin

I akuzuari: kur ndodhi kjo?

²¹⁴ PINK I/ Dosja e Përgjimit të Ardianit VII, f. 143-151

L.: të premtën...ata i futën ata në një kabinë dhe i mbajtën atje deri në mëngjes, ata ngrinë, ai i mori në mëngjes pastaj i dërgoi ata në shtëpi

I akuzuari: ...po thoni të premtën e shkuar?

L.: po

I akuzuari: Jo, kjo nuk është e vërtetë, ata nuk ishin me mua

L.:: Po ju them se kjo është shumë e keqe imagjinoni kur të thërrasin Turqinë dhe t'u thonë se ata duhej të ecnin 5 orë dhe ata po ngrinin e di?

I akuzuari: ... 2 dhe e gjysmë e shumta 3 sepse nëse ecën 5 orë mund të arrish Ljublanën, unë punoj në pjesën tjetër...

Luljeta: kjo është e kuptueshme; po të kalosh në mënyrë të paligjshme duhet të ecësh të paktën një, dy or tre orë por të ecësh pesë orë...

17 shkurt 2012

Në orën 16:03:02, i akuzuari (xxx) kontaktoi me një PMP (xxx)²¹⁵

Gjatë kësaj bisede i akuzuari thotë së është e vështirë të punosh për shkak të "çizmeve". Bashkëpunëtori i tij e informon atë se ai u burgos në Hungari për ca kohë. I akuzuari e pyet atë nëse është e mundur të shkohet nga Serbia në Kroaci.

Argumenti i Akuzës ishte se "çizmet" është referencë e koduar për policinë.

²¹⁵ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A.VII, f. 92-95

26 shkurt 2012

Në orën 20:33:26, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)²¹⁶

M.C. i tregon të akuzuarit se ai do të shkonte në Ilirska Bistrica dhe do të shkonte në një rrugë të përshkruar nga i akuzuari për të vlerësuar situatën. Ai tha se ai do të ishte i lirë gjithë pranverën.

Në orën 20:36:52, i akuzuari (xxx) kontaktoi me M.C. (xxx)²¹⁷

I akuzuari i thotë M.C. të kalojë nga Kroacia në Slloveni.

Provat e mbikëqyrjes

I akuzuari u vrojtua duke takuar një grup migrantësh në Aeroportin e Prishtinës. Ky grup përfshinte G.K. dhe T.H.²¹⁸

Këta persona ishin kthyer nga Kroacia pasi ishin kapur dhe arrestuar më 10 mars 2012 në Ilirska Bistrica, Slloveni, një qytezë ngjitur me kufirin Kroaci-Slloveni, pasi kishin hyrë në mënyrë të paligjshme në Slloveni sipas veprimeve të grupit të organizuar kriminal.

Hetimi financiar

Në bazë të një Urdhri për Zbulimin e të Dhënave Financiare, të nxjerrë më 19 korrik 2012 kundër të akuzuarit²¹⁹, hetimet zbuluan se i akuzuari kishte marrë 1.901,61 euro përmes

²¹⁶ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 389-390

²¹⁷ PINK I/ Dosja e Përgjimit të A. VII, f. 391-392

²¹⁸ Raporti i Mbikëqyrjes i Policisë së EULEX-it për datën 15.3.2012, A.B., DOSJA 1.

²¹⁹ Shih A.B., DOSJA IX.

Western Union nga Z.G., një anëtar i dyshuar i grupit të organizuar kriminal në Kroaci, ndërmjet dhjetorit 2010 dhe mesit të vitit 2011.²²⁰

Deklaratat e të pandehurit

I pandehuri A.B. u intervistua në katër raste nga ana e Prokurorit dhe hetuesit e EULEX-it dhe Policisë së Kosovës. I pandehuri mohoi të kishte bërë apo marrë ndonjëherë prej thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS përkatëse, dhe në vend të kësaj pretendoi se e kishte humbur telefonin e tij gjatë datave përkatëse, por e kishte gjetur atë më vonë në shtëpinë e tij. Përgjimi i telekomunikimeve e tij dhe të dhënat e vendndodhjeve, të nxjerra prej tyre, zbulojnë se komunikimet u dërguan dhe morën në përputhje me lëvizjet e A.B., siç u zbulua nga mbikëqyrja fotografike në vende publike.

Për më tepër, nisur nga komunikimi i tij i madh me "N.", O.K., L.K. dhe anëtarë të tjerë të dyshuar të grupit të organizuar kriminal të dyshuar, Prokurori e konsideron edhe shpjegimin e të pandehurit se ai nuk i njeh ata ose nuk mund t'i identifikonte ata si të pabesueshëm dhe tregues të mungesës së bashkëpunimit të tij në këtë procedurë.

G. PËRGJEGJËSIA E TË AKUZUARIT

Aktakuza e ngarkoi të Akuzuarin me dy Akuza.

Në Akuzën 1 ai u akuzua për krim të organizuar, sipas nenit 274 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së.

Në Akuzën 2 ai u akuzua për kontrabandë të migrantëve, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, të KPK-së, në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPK-së.

²²⁰Shih 'Raportin Përmbledhës të Hetimit Financiar ('PINK') të Policisë së Kosovës, datë 17.09.2012 (SPRK/in/OC/1078, datë 26.09.2012), f.1-86, A.B, DOSJA IX.

Në Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë, të datës 30 tetor 2013, të nënshkruar nga palët, deklarohet se “Prokurori nuk do të insistojë më në Akuzën 1 të Aktakuzës.” Gjatë seancës për Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë më 30 tetor 2013, Prokurori deklaroi se e tërheq Akuzën 1. Akuza 2 u ndryshua për ta ngarkuar të akuzuarin vetëm në bazë të nenit 138 paragrafi 1.

Gjykata e pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe e rrëzoi Akuzën 1.

Baza e pranimit të fajësisë sipas Akuzës 2 ishte se i Akuzuari ishte përfshirë në kontrabandimin e migrantëve, kryesisht me origjinë turke, nga Kosova në Kroaci dhe Slloveni dhe më tutje në destinacionin e tyre përfundimtar në Itali dhe vende të tjera të BE-së, përfshirë Hungarinë, Austrinë, Gjermaninë dhe vende të tjera të Evropës Perëndimore. Në mënyrë të veçantë:

Se **ndërmjet 5 shkurtit 2012 dhe 25 shkurtit 2012**, A.B. kontrabandoi në mënyrë të paligjshme një grup prej gjashtë migrantësh turq nga Kroacia në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar. Këta migrantë u identifikuan me emrat Z.G.,, e lindur më xxx, A.G.,, i lindur më xxx, M.G, i lindur më xxx, B.G.,, i lindur më xxx, dhe G.K.,, i lindur më xxx.

Planifikimi i veprës penale filloi më 5 shkurt 2012, kur A.B. bëri marrëveshje me N., rekrutues dhe organizatori kryesor në nivel ndërkombëtar, i cili kontrabandonte migrantë rregullisht përmes Malit të Zi dhe Kroacisë për në Slloveni dhe Itali. Pas kësaj marrëveshjeje, A.B. kontaktoi me anëtarët e tjerë të grupit kriminal nga 06 deri më 19 shkurt 2012, me qëllim që t’i bënin ata gati. Këta anëtarë përfshinin Z.G.1 në Kroaci, Sh.B. në Itali, A. (mbiemri i paditur) në Kosovë, dhe një anëtar të paidentifikuar të grupit në Mal të Zi. A. do të punonte me A.B. në Kosovë për të bashkërenduar shoferët, dhe Z.G.1 do të kujdesej për transportimin e migrantëve nga Kroacia drejt Sllovenisë, ndërsa Sh.B. do të mbikëqyrte kalimin e tyre më tutje në Itali dhe transportimin më pas.

Planifikimi i operacionit u konkretizua më tej më 21 shkurt 2012, kur A.B. bëri marrëveshje të drejtpërdrejtë me L.K.,, organizatorja kryesore në nivel më lart se N. në të njëjtin grup të

organizuar kriminal, për të kontrabanduar një grup prej gjashtë personash në ditët e ardhshme. Këta gjashtë migrantë ishin shtetasit turq Z.G., A.G., M.G., B.G. and G.K.. L.K. e informoi A.B. se migrantët ishin një familje e përbërë nga pesë të rritur dhe një fëmijë shtatë vjeçar. Ai ra dakord për kontrabandimin e këtyre personave nga Zagrebi, Kroaci, për në Itali. Anëtarët e tjerë të grupit kriminal ndërkombëtar më të gjerë i kishin transportuar tashmë këta migrantë nga Turqia në Kroaci, ku do t'i merrte përsipër A.B.. Migrantëve u ishin kërkuar secilit nga 1400 euro vetëm për transportimin e tyre nga Kroacia përmes Sllovenisë për në Itali.

Ndërsa L.K. ishte pika e drejtpërdrejtë dhe kryesore e kontaktit për A.B., drejtimi i përgjithshëm u bë nga bashkëshorti i saj O.K., udhëheqësi i grupit kriminal. Kjo u demonstrua kur L. kërkoi leje nga O., ndërsa ishte duke folur në telefon me A.B. rreth operacionit të ardhshëm. Edhe A.B. mori udhëzime drejtpërdrejt nga O.K. në lidhje me kontrabandimin e këtij grupi konkret migrantësh. Në veçanti, O.K. pyeti në lidhje me shoferët, kohën dhe modalitetet e lëvizjes së migrantëve dhe hyrjen në shtetin e destinacionit të planifikuar, dhe ku do të strehoheshin migrantët në Rjekë dhe paratë që do t'u merreshin atyre në Kroaci. C.K., vëllai i O, gjithashtu u përfshi në operacionet e kontrabandimit nga Turqia dhe komunikoi direkt me A.B.

Roli i A.B ishte të komunikonte me transportuesit nga Kroacia për në Slloveni, për në Itali, fazat vendimtare të udhëtimit të migrantëve, duke pasur parasysh se këto ishin fazat në të cilat u konkretizua krimi me kalimin e paligjshëm të kufijve për në shtetet e BE-së. Për ta realizuar këtë, A.B foli me M.C. M.C organizoi shoferët direkt, duke komunikuar përsëri me A.B. shpesh për të marrë udhëzime dhe për të rënë dakord për punët e parave. Për më tepër, A.B. organizoi akomodimin e migrantëve në Opatija, Kroaci, në "Hotel Opatija" të administruar nga G.N, një anëtare tjetër e grupit në Kroaci, e cila gjithashtu punon me M.C.

Krahas kësaj, A.B. u përfshi në aktivitetet në Slloveni me bashkëpunëtorin e tij të njohur si R.L., i cili kontribuoi në kryerjen e veprës si shofer i grupit nga Sllovenia për në Itali.

Në mbrëmjen e datës 23 shkurt 2012, migrantët u larguan nga Zagrebi, Kroaci, për në Rjekë, Kroaci, në dy grupe. Një pjesë e grupit shkoi me taksì për 350 euro nga Zagrebi në Rjekë, ndërsa pjesa tjetër shkoi me autobus pasi A.B. i shprehu shqetësimin e tij L.K. se ata do të kapeshin në rast se udhëtonin të gjithë me taksì gjatë natës. Në Rjekë ata u takuan nga shoferët e organizuar nga M.C., i cili i dërgoi ata në “Hotel Opatija” të administruar nga G.N... Migrantëve iu kërkua të paguajnë 200 euro për të qëndruar një natë. Më 24 shkurt 2012, A.B. diskutoi rregullimet përfundimtare me M.C. për transportimin e migrantëve nga Rjeka, Kroaci, në Slloveni dhe më pas në Itali. M.C. dhe një bashkëpunëtor tjetër udhëtuan për në Rjekë që në mbrëmje, me qëllim që të ishin gati për të transportuar migrantët të nesërmen në mëngjes.

Më 25 shkurt 2012, rreth orës 05:00, M.C. dhe një shofer tjetër i morën migrantët nga Hotel Opatija. Në këtë moment, migrantëve iu kërkua t’u dorëzojnë shoferëve 1,200 euro të tjera (500 euro për njërin, 700 euro për tjetrin). Tre migrantë udhëtuan në secilin prej të dy automjeteve në drejtim të kufirit kroat me Slloveninë. Në fakt kufiri u kalua në Starod, dhe migrantët hynë në Slloveni në mënyrë të paligjshme dikur para orës 11:00.

Rreth orës 11:00 të asaj dite, migrantët u takuan nga një shofer tjetër në një automjet Mercedes në Račice, rajoni Ilirska Bistrica, Slloveni, i cili ishte siguruar nga A.B. për t’i dërguar ata në Itali. Plani i mëparshëm kishte qenë që ata të dërgoheshin në Udine, Itali, por atë ditë shoferi i dërgoi ata drejt Triestes, Itali.

Migrantët Z.G., A.G., M.G., B.G. dhe G.K., u ndaluan të gjithë në një pikë kontrolli të policisë pasi kishin hyrë ilegalisht në Itali ndërmjet orës 11:00 dhe 13:00, dhe u deportuan në Slloveni, ku ata u arrestuan nga Policia Sllovene në rajon Ilirska Bistrica.

Moshat dhe identitetet e migrantëve përputhen me rrethanat faktike të komunikuar në thirrjet e përgjuara të A.B., d.m.th. se migrantët ishin një familje, përfshirë një fëmijë. Veçanërisht, fëmija më i ri i grupit (B.G.) ishte vetëm xxx vjeç në kohën e ngjarjeve, madje edhe më i ri se mosha e treguar xxx vjeç. Përveç kësaj, u kontrabanduan edhe tre fëmijë të tjerë,

sepse në atë kohë R.G. ishte xxx vjeç, A.G. xxx vjeç dhe M.G. xxx vjeç. Vetëm dy anëtarë të grupit ishin të rritur (Z.G., xxx, dhe G.K., xxx).

Më tej, se **në mes të 26 shkurtit 2012 dhe 10 marsit 2012**, A.B. kontrabandoi dy migrantë në mënyrë të paligjshme nga Kroacia në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar. Këta migrantë u identifikuan si H.K., shtetas turk, i lindur më xxx (mosha xxx vjeç), dhe G.K., shtetas i Kosovës, i lindur më xxx (mosha xxx vjeç).

Planifikimi i veprës penale filloi më 26 shkurt 2012, kur A.B. pranoi të kontrabandonte G.K nga Kosova për në Itali. Më tej, më 27 shkurt 2012, A.B. ra dakord me vëllezërit K. për të transportuar dy migrantë turq nga Zagrebi, Kroaci, në Itali. Migrantët tashmë ishin transportuar nga Turqia në Kroaci nga anëtarë të tjerë të grupit të organizuar kriminal ndërkombëtar. Më 6 mars 2012, O.K. thirri A.B. personalisht, në të cilin moment u sqarua se do të shkonte një migrant turk. Ky migrant që do të kontrabandohej ishte H.K... Më vonë atë ditë, A.B. ra dakord me L.K. se H. do të transportohej në të njëjtën kohë si migranti nga Kosova.

Roli kryesor i A.B. ishte të komunikonte me transportuesit nga Kroacia për në Slloveni dhe për në Itali, fazat në të cilat krimi u konkretua përsëri me kalimin e paligjshëm të kufijve për në shtetet e BE-së. Për ta realizuar këtë, A.B. diskutoi për aktivitetet në Kroaci me M.C., i cili organizoi shoferët. A.B. ngarkoi me detyrë edhe G.N., e cila ofroi strehim në "Hotel Opatija" pranë Rjekës, Kroaci. M. dhe G. i raportuan edhe Z.M., menaxher i grupit kriminal në Kroaci.

Më tutje, A.B. punoi me Sh.B., shtetas i Kosovës, T.H., shtetas i Kosovës, dhe H.B., shtetas serb i cili jeton në Mal të Zi, të cilët shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues. Këta tre anëtarë të grupit i shoqëruan migrantët personalisht përgjatë udhëtimit. Ata gjithashtu hynë vetë ilegalisht në Slloveni.

Migrantët u nisën nga Rjeka, Kroaci, në Slloveni më 8 mars 2012, duke kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin në rajonin Ilirska Bistrica, Slloveni, me anije në afërsi të Koperit. Ata e

vazhduan udhëtimin e tyre drejt Italisë, natën e 9 marsit 2012, në përpjekje për të shmangur policinë kufitare.

A.B. komunikoi drejtpërdrejt me migrantët përgjatë rrugës, duke u thënë atyre në detaje të sakta ku ta kalojnë kufirin ndërmjet Sllovenisë dhe Italisë. Nga këto komunikime, natyra e paligjshme e hyrjes është jashtëzakonisht e qartë. Për shembull, ai i udhëzoi migrantët mos të kërcejnë gardhin, por të ecin përreth tij, përmes linjave hekurudhore, pasi kishte qen roje. Më tej ai i orientoi migrantët të ecin nëpër pisha drejt Italisë, duke treguar se ata po hynin në Itali nëpërmjet një pike të paligjshme të kalimit të kufirit, nëpër pyll.

Migrantët H.K., dhe G.K., si dhe transportuesit Sh.B., H.B., T.H. u ndaluan të gjitha në një pikë kontrolli të policisë pasi kishin hyrë ilegalisht në Itali në orët e hershme të 10 marsit 2012. Ata u deportuan në Slloveni, ku u arrestuan nga policia sllovene në rajonin Ilirska Bistrica.

Nga komunikimet e përgjuara pas arrestimeve, u zbulua roli i Sh.B., H.B., T.H. si transportues të grupit kriminal. Ata i vendosën në një kamp për migrantët e paligjshëm në Kroaci, së bashku me dy migrantët, pasi edhe hyrja e tyre ishte e paautorizuar. T.H. dhe G.K. u liruan dhe i kthyen prapsh për në Kosovë më 15 mars 2012, ndërsa Sh.B. u lirua dhe e kthyen prapsh më 16 mars 2012. Në veçanti, natyra e paligjshme e aktiviteteve të tyre në Kroaci është demonstruar nga sugjerimi që A.B. i bëri Sh.B. që të dilte me një justifikim për praninë e tyre në Kroaci për Policinë Kufitare të Kosovës pas mbërritjes në aeroportin e Prishtinës, gjë që nuk ishte e vërtetë.

Mbikëqyrja fotografike e A.B. nga Policia e EULEX-it më 12 mars 2012 vërteton më tej provat e përfshirjes së tij në këtë operacion kontrabandimi, pasi ai është fotografuar duke marrë T.H. dhe G.K. nga aeroporti i Prishtinës.

Më tej, se **në ndërmjet 24 shkurtit 2012 dhe 16 marsit 2012**, A.B. kontrabandoi katër migrantët në mënyrë të paligjshme nga Kosova përmes Malit të Zi dhe Kroacisë në Slloveni, me Italinë si destinacion të synuar. Këta migrantë u identifikuan si A.B., shtetas i Kosovës, i lindur më xxx

(xxx vjeç), M.H., shtetas i Kosovës, i lindur më xxx (xxx vjeç), R.J., shtetas i Kosovës, i lindur më xxx (xxx vjeç), dhe A.K, shtetas i Kosovës, i lindur më xxx (xxx vjeç).

Planifikimi i operacionit të kontrabandës filloi më 24 shkurt 2012, kur A.B. mori një telefonatë nga "V", një anëtar i grupit të tij në Kosovë, i cili e informoi atë se ishin rekrutuar katër migrantë (të referuar si "katër automjete" në gjuhë të koduar) dhe ata ishin gati për t'u transportuar nga Kosova jashtë vendit. Në përgjithësi, A.B i raportoi O.K. për operacionin. Migrantëve iu kërkua të paguajnë 2500 euro secili vetëm për transportimin e tyre nga Kosova përmes Malit të Zi, Kroacisë dhe Sllovenisë për në Itali. Ata ia lanë këtë shumë parash I. (mbiemri i paditur) në Kosovë, si siguri deri sa të përfundonte transportimi i tyre për në Europë.

Roli kryesor i A.B ishte të komunikonte me transportuesit nga Kroacia në Slloveni, në Itali, fazat në të cilat krimi u konkretizua përsëri me kalimin e paligjshëm të kufijve për në shtetet e BE-së. Për ta realizuar këtë, A.B diskutoi për aktivitetet në Kroaci me M.C., i cili organizoi shoferët. A.B ngarkoi me detyrë edhe G.N, e cila ofroi strehim në "Hotel Opatija" pranë Rjekës, Kroaci. M. dhe G. i raportuan edhe Z.M, menaxher i grupit kriminal në Kroaci.

Më tej, A.B. punoi me M.H, shtetas i Kosovës, I.H, shtetas i Kosovës, H.B, shtetas serb i cili jetonte në Mal të Zi, dhe R.R., shtetas i Serbisë. I.H., H.B., dhe R.R shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues nga Kosova e më tutje, ndërsa M.H. u kujdes për organizimin e punës në anën italiane. I.H., H.B., dhe R.R. i shoqëruan personalisht migrantët përgjatë udhëtimit. Ata gjithashtu hynë vetë ilegalisht në Slloveni.

Krahas kësaj, A.B. diskutoi për aktivitetet në Mal të Zi, një vend transit, me bashkëpunëtorin e tij të njohur si "C.", i cili kontribuoi në kryerjen e veprës si shofer për grupin nga Mali i Zi në Kroaci dhe Slloveni.

Migrantët u larguan nga Kosova për në Mal të Zi më ose rreth 14 marsit 2012. Migrantët dhe transportuesit qëndruan me "C." në Mal të Zi. A.B. i tha "C." të siguronte që secili migrant t'i

jepte shoferit edhe 300 euro dhe 700 euro për një tjetër bashkëpunëtor malazez në menaxhimin e transportit. Në këtë rast, bashkëpunëtor malazez në fakt mori 1.000 euro nga migrantët.

Më 15 mars 2012, nga Mali i Zi migrantët u vozitën nga dy anëtarë malazezë të grupit kriminal për në Kroaci, ku ata u akomoduan nga G.N. në "Hotel Opatija", pranë Rjekës. Në një moment, ata ndërruan veturat për t'iu shmangur autoriteteve. Pastaj ata u dërguan me varkë për në Dubrovnik, Kroaci. Gjatë rrugës A.B. mbajti kontakt me "C." dhe anëtarët e tjerë malazezë të grupit kriminal, duke u dhënë udhëzime të vazhdueshme për rrugën që duhej të ndiqnin, marrëveshjet për të hollat dhe strehimin. Varka mbërriti rreth orës 09:40 më 16 mars 2012.

Nga atje, migrantët u dërguan në drejtim të një kalimi kufitar në rajonin Ilirska Bistrica, Slloveni. A.B. i tha një shoferi tjetër nga Sllovenia t'i priste migrantët në anën tjetër të kufirit Kroaci-Slloveni. Migrantët e kaluan kufirin në këmbë në natën e 16 marsit 2012 dhe orët e hershme të 17 marsit 2012. A.B. ishte në dijeni të planeve që ata të shkonin tutje për të kaluar kufirin nga Sllovenia për në Itali, në drejtim të Gorizias, në rajonin Venezia Giulia Fruili në verilindje të Italisë.

Megjithatë, të katër migrantët, A.B., M.H., R.J., dhe A.K. si dhe transportuesit I.H., H.B dhe R.R. u kapën dhe u arrestuan të gjithë nga policia sllovene në Ilirska Bistrica.

Më tej, se **ndërmjet 17 marsit 2012 dhe 28 marsit 2012**, A.B. kontrabandoi tre migrantë në mënyrë të paligjshme nga Kosova përmes Malit të Zi dhe Kroacisë për në Slloveni, me Italinë si destinacioni i synuar. Një prej migrantëve u identifikua si B. (mbiemri i paditur), shtetas i Kosovës.

Planifikimi për këtë operacion kontrabandimi filloi më 17 mars 2012, kur A.B. e rregulloi me një rekrutues të dërgonte një grup të ri jashtë shtetit për 2.800 euro për migrant. Rekrutuesi e informoi A.B. se ai u kishte kërkuar migrantëve 200 euro më shumë, por A.B. i tha se mund t'i

mbante ato për vete.

Roli kryesor A.B. ishte të komunikonte me transportuesit nga Kosova për në Mal të Zi, nga Mali i Zi në Kroaci, nga Kroacia në Slloveni dhe në vazhdim prej andej për në Itali. Krimi u konkretizua me kalim të paligjshëm të kufirit Kroaci-Slloveni dhe hyrjen pa leje në Slloveni dhe në Itali.

Në realizimin e kontrabandimit të migrantëve, A.B. diskutoi për aktivitetet në Mal të Zi me një shok të treguar me emër dhe në Kroaci me M.C., secili prej të cilëve organizoi shoferët brenda zonave përkatëse të tij. A.B. ngarkoi me detyrë edhe G.N. dhe motrën e saj, të cilat siguruan strehim në Hotel Opatija afër Rjekës, Kroaci. M., G. dhe motra e saj i raportuan edhe Z.M., menaxher i grupit kriminal në Kroaci.

Më tej, A.B. punoi me I.H. dhe Sh.B, të cilët shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues nga Kosova e tutje.

Në ose rreth orës 04:00 të 22 marsit 2013, tre migrantë u larguan nga Kosova për në Mal të Zi. Ata mbërritën në Budva, Mali i Zi, rreth orës 11:00, ku u takuan nga një anëtar i grupit në Mal të Zi në stacionin e autobusëve. Ata u strehuan për natën nga një bashkëpunëtor tjetër në Mal të Zi. Të nesërmen, ata u vozitën për në Dubrovnik, Kroaci, ku ata u takuan nga një transportues tjetër. A.B. i tha bashkëpunëtorit të tij të njohur si "K H" në Mal të Zi të siguronte që secili prej migrantëve t'i jepte shoferit nga 300 euro në Budva dhe 100 euro të tjera secili kur të mbërrinin në Dubrovnik. Grupi kaloi kufirin Kroaci-Slloveni në ose rreth datës 27 mars. Pas kësaj, ata do të udhëtonin tutje në Itali me një shofer tjetër. Megjithatë, migrantët u arrestuan nga policia sllovene dhe u deportuan në Kosovë.

Duke pasur parasysh provat në të cilat mbështetet akuza në këtë lëndë, Trupi Gjykes gjen se vetë-deklarimi i fajësisë mbështetet nga faktet dhe provat materiale. Trupi Gjykes e pranon vetë-deklarimin e fajësisë.

H. DËNIMI

Në një draft të hershëm të marrëveshjes për pranimin e fajësisë u propozua që i Akuzuari ta pranonte fajësinë për Akuzën 2 dhe që ai të dënohej me tre vjet burgim dhe një gjobë në shumën e 500 eurove. Gjoha do të shndërrohej në një periudhë të mëtejshme burgimi nëse mbetej e papaguar.

Neni 138 paragrafi 1 i KPK-së së 'vjetër' parashikonte një afat burgimi nga 2 deri në 12 vjet. Neni 170 i KPRK 'të ri' parashikon një afat burgimi nga 2 deri në 10 vjet. Megjithatë, sipas KPRK 'të ri', do të ishte e mundur që i akuzuari të gjobitej. Gjoha pas dënimit sipas nenit 138 të Kodit 'të vjetër' nuk ishte parashikuar në ligj. Në këto rrethana, Trupi Gjykses e gjeti Nenin 138 të kodit 'të vjetër' më të favorshëm për të Akuzuarin, në rrethanat ku mundësia e shndërrimit të një gjobe me periudhë burgimi sipas nenit 46, paragrafi 3, të KPRK-së lejon një maksimum teorik prej tre (3) vitesh burgim në rast të mospagesës së një gjobe që Gjykata mund të ketë zgjedhur ta vendosë.

Në çdo rast, dënimi i propozuar prej tre vjetësh burg ishte brenda dënimeve maksimale të parashikuara në të dyja kodet.

Në bazë të kushteve të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, i Akuzuari pranoi t'i jepte prokurorit ose policisë deklaratë lidhur me aktivitetet e personit të njohur si "N.", i cili është i njohur për të pandehurin. Kjo intervistë do të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur. Ky informacion do të përfshijë emrin e plotë të N. dhe një përshkrim të përfshirjes së tij në kontrabandimin e migrantëve. Më tej, në rast se ndaj "N." ngrihet aktakuzë në Kosovë, i pandehuri do të japë prova kundër tij për prokurorinë në shqyrtimin gjyqësor.

Para se Gjykata të merrte marrëveshjen e nënshkruar me shkrim mbi pranimin e fajësisë, i Akuzuari kishte vepruar në pajtim me pjesën e parë të detyrimit të tij sipas marrëveshjes në fjalë për pranimin e fajësisë.

I Akuzuari ishte dënuar për një vepër të rëndë penale.

I Akuzuari është xxx vjeç dhe i martuar, ka një fëmijë xxx vjeçar. Ai i përshkroi të ardhurat e tij si “mesatare”.

Trupi Gjykues pranoi dënimin prej tre vjetësh burgim të propozuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Gjykata gjen se dispozitat e nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale janë zbatuar dhe se i akuzuari e nënshkroi marrëveshjen për pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare dhe se në kohën që e nënshkroi, ai i kuptoi rëndësinë dhe pasojat e saj në lidhje me sjelljen e tij të ardhshme. Gjykata vëren se kopjet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë janë mbajtur nga palët dhe një kopje është ruajtur në dosjen e gjykatës.

Për arsyet e cekura këtu, shqiptojmë këtë Aktgjykim.

Gjyqtari Malcolm Simmons

Kryetar i trupit gjykues

Gjyqtari Manuel Soares

Anëtar i trupit gjykues

Gjyqtari Zejnullah Gashi

Anëtar i trupit gjykues

Valentina Gashi

Proces- mbajtëse

SHTOJCAT

Të gjithë urdhrat e gjykatës dhe prokurorit

Të gjitha raportet policore, përfshirë

‘Raporti Përmbledhës për Lëndën Hetimore PINK’ i Policisë së Kosovës, datë 06.04.2012, PINK: Dosja e Policisë III, Tab. 13, f.85-206.

Raporti Përfundimtar i Policisë së EULEX-it për A.B., datë 12.4.2012, A.B, DOSJA IX

Raporti 3451 i Policisë së EULEX-it për analizën e informacionit për migrantët, i mbledhur gjatë hetimit, datë 02.03.2012 (SPRK/in/OC/258, datë 05.03.2012), PINK: Dosja e Policisë II, Tab. 18, f.149-1860.

Raportet për të dhënat e abonentëve telefonikë

Tabulatet e përgjimeve, A.B, DOSJET VI, VII dhe VIII.

Raportet 15-ditore të policisë për përgjimet telefonike, A.B, DOSJA VI

Raporti 3084 i EULEX-it për përgjimet, ‘Rezultatet dhe vlerësim i përgjithshëm’, datë 15.12.2011 (SPRK/767/in/OC, datë 15.12.2011), PINK: Dosja e Policisë 1, Tab. 23, f.292-326AS.

Raporti 5638 i Policisë së EULEX-it, datë 10.04.2013 (SPRK/in/324/OC, datë 11.4.2012) për rezultatet e analizës së regjistrimeve telefonike të numrave telefonikë të përdorur nga A.B, A.B, Dosja VI

Raportet e ekspertëve për analizën telefonike, përfshirë:

Raportin e Policisë së Kosovës për të Dhënat, datë 10.5.2012 (SPRK/in/OC/in/585, datë 14.05.2012), PINK: Dosja e Policisë IV, Tab 7, f.92-97E.

Raporti 4742 i Policisë së EULEX-it, datë 04.10.2012, me titull ‘Analiza pas Ekzaminimit Forensik’, (SPRK/in/OC/1156, datë 09.10.2012), A.B Dosja V, Tab 3; f. 446-461.

Raport i EULEX-it për Ekzaminimin Forensik, datë 30.7.2012, A.B Dosja V.

Raporte për verifikimin e personave,

Të gjithë raportet dhe fotot e mbikëqyrjes, përfshirë

Raportet e Policisë së EULEX-it për mbikëqyrjen, veçanërisht raporti i datës 15 mars 2012, në DOSJEN I të Lëndës A.B.

Raportet e kontrolleve, përfshirë

Raporti i Policisë së Kosovës për kontrollin e shtëpisë së A.B, datë 18.4.2012, DOSJA IV e A.B,

Raportet e hetimit financiar, përfshirë:

‘Raporti Përmbledhës i Hetimit Financiar (‘PINK’)’ i Policisë së Kosovës, datë 17.09.2012 (SPRK/in/OC/1078, datë 26.09.2012), PINK: Dosja e Policisë VII, Tab 1, f.1-86, dhe A.B, DOSJA IX

PINK: Hetimi financiar i A.B, O.A, B.F, F.A, dhe të tjerëve 2012, PINK: Dosja e Policisë VII dhe A.B, DOSJA IX

Materialet e përzgjedhura të ndihmës ligjore ndërkombëtare në Lëndën A.B,, DOSJA III, përfshirë

Deklaratat e M.C., Z.G., N.P., G.N. dhe Z.M., të marra nga autoritetet kroate, A.B, DOSJA III.